



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 132

Tiranë – E mërkurë, 5 tetor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 66/2022, datë 15.9.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit.....
	16641
Dekret i Presidentit nr. 13854, datë 27.9.2022	Për shpallje ligji.....
	16645
Ligj nr. 67/2022, datë 15.9.2022	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për shkëmbimin e informacionit për qëllime të lidhura me migracionin..
	16646
Dekret i Presidentit nr. 13855, datë 27.9.2022	Për shpallje ligji.....
	16652
Vendim i Kuvendit nr. 71/2022, datë 22.9.2022	Për mosmiratimin e një kandidature për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.....
	16653
Vendim i Kuvendit nr. 72/2022, datë 22.9.2022	Për zgjedhjen e zotit Petraq Lika anëtar të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.....
	16653
Vendim i Kuvendit nr. 73/2022, datë 22.9.2022	Për zgjedhjen e zotit Edmond Tullumani anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.....
	16653
Vendim i Kuvendit nr. 74/2022, datë 22.9.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.....
	16654

Vendim i Kuvendit nr. 75/2022, datë 22.9.2022	Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	16657
Vendim i Kuvendit nr. 76/2022, datë 22.9.2022	Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për përpunimin e materialeve zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	16659
Vendim i Kuvendit nr. 77/2022, datë 22.9.2022	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë....	16659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 28.9.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 688, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë”.....	16660
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 28.9.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 350, datë 19.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.....	16661
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 31.5.2022	Çështja X dhe të Tjerët kundër Shqipërisë (kërkesat nr. 73548/17 dhe 45521/19).....	16662
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 431, datë 27.9.2022	Për disa shtesa në urdhrin nr. 365, datë 10.8.2022, “Për importin e kafshëve të llojit derr, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Hungaria, Letonia, Ukraina, Rumania, Italia, Gjermania, Lituania, Moldavia, Sllovakia, Serbia, Estonia, Bullgaria, Polonia dhe Maqedonia e Veriut”.....	16674
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 4191, datë 28.9.2022	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar.....	16675
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 4192, datë 28.9.2022	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në udhëzimin nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”.....	16686
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 23, datë 26.9.2022	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....	16697
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 24, datë 26.9.2022	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....	16697
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 25, datë 26.9.2022	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....	16700
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 420, datë 29.9.2022	Për licencat dhe tarifat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta.....	16702

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 88/7, 28.9.2022	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, për disa shtesa në vendimin nr. 1196, datë 3.12.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, “Shkodër–Hani i Hotit”	16703
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim nr. 637/7, datë 30.9.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik të Durrësit”	16704
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Denis Jangulli	16707
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Agron Kanani	16707



LIGJ
Nr. 66/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË EMIRATEVE TË BASHKUARA
ARABE, PËR BASHKËPUNIMIN NË
FUSHËN E SIGURISË DHE LUFTËS
KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.9.2022.

Shpallur me dekreten nr. 13854, datë 27.9.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË
BASHKUARA ARABE, PËR
BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E
SIGURISË DHE LUFTËS KUNDËR
TERRORIZMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, e përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe (në vijim referuar kolektivisht si “Palët” dhe individualisht si “Pala”),

me dëshirën për të zhvilluar lidhjet e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe duke kontribuar në rritjen e bashkëpunimit të tyre në fushën e ruajtjes së sigurisë dhe luftës kundër krimit;

me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre në fushën e luftës së krimit në të gjitha format e tij dhe mbrojtjen e ligjit dhe rendit publik;

të vetëdijshëm ndaj kërcënimit serioz që paraqet terrorizmi, krimi i organizuar dhe format e tjera të krimeve që kërcënojnë sigurinë e të dyja vendeve;

duke respektuar parimet e sovranitetit dhe barazisë së shteteve dhe mosndërhyrjen në punët e brendshme, si dhe parimet e tjera të njohura në instrumentet e tjera ndërkombëtare të detyrueshme për secilën palë,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në bazë të kësaj Marrëveshjeje për të rritur bashkëpunimin dypalësh ndërmjet tyre, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, përvojave dhe trajnimeve, në të gjitha fushat e sigurisë dhe policisë brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit, me synimin për të parandaluar,



zbuluar dhe luftuar veprat penale dhe fenomenet kriminale të mëposhtme:

1. Veprat terroriste, veprimtaritë e grupeve terroriste, drejtuesit e këtyre grupeve, pjesëtarët dhe vendet e përqendrimit dhe trajnimit të tyre;

2. Veprat penale të financimit të terrorizmit nën çdo kategori dhe mbështetjen e tij ose përdorimin e dyshuar në mbështetje dhe financim të terrorizmit, duke përfshirë parandalimin e pagesës së shpërblimeve për grupet terroriste;

3. Krimet e rënda kundër personit dhe pronës;

4. Veprat penale që përfshijnë korrupsionin;

5. Krimet e organizuara transnacionale;

6. Prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i armëve, municioneve, eksplozivëve dhe substancave bërthamore dhe kimike, materialeve radioaktive dhe biologjike, si dhe teknologjisë që lidhet me to dhe armëve të shkatërrimit në masë, dhe armëve jokonvencionale;

7. Trafikimi i personave;

8. Prodhimi i paligjshëm, kontrabanda dhe trafikimi i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, duke përfshirë prekursorët, kimikatet dhe materialet e tjera të përdorura në prodhimin e tyre;

9. Veprat penale të pastrimit të parave;

10. Veprat penale ekonomike dhe financiare;

11. Veprat penale që lidhen me dhunën në familje dhe shfrytëzimin e fëmijëve, veçanërisht aktivitetet *online*;

12. Veprat penale të falsifikimit dhe promovimit të monedhës, falsifikimi i dokumenteve zyrtare, dokumenteve financiare ose obligacioneve, letrave me vlerë, kartave të krediti dhe mjeteve të financimit;

13. Vjedhja dhe kontrabanda e veprave kulturore, historike dhe letrare me vlera artistike;

14. Veprat penale që lidhen me pronësinë intelektuale;

15. Veprat penale që lidhen me vjedhjen e automjeteve, kontrabandën dhe trafikimin e paligjshëm të tyre;

16. Veprat penale që lidhen me transportin dhe komunikimin;

17. Veprat penale të lidhura me taksat;

18. Veprat penale të teknologjisë së informacionit;

19. Çdo krim tjetër i rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit

Palët do shkëmbejnë informacionin në fushën e sigurisë, në luftën kundër krimeve dhe fenomeneve specifike, në fushat e bashkëpunimit sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i zbulojnë ato, veçanërisht në informacionin e mëposhtëm:

1. Krimet që planifikohen të kryhen ose ato që janë kryer brenda kufijve gjeografikë të të dyja palëve;

2. Personat, bandat dhe grupet terroriste të dyshuar për kryerjen e këtyre krimeve;

3. Njerëzit e arratisur;

4. Njerëz që raportohen të zhdukur;

5. Shkëmbimi i informacionit mbi transaksionet financiare që lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, ose financimin e organizatave të paligjshme dhe veprave penale të lidhura me to;

6. Shkëmbim informacioni dhe përvojash në fushën e luftës kundër veprave penale që lidhen me shfrytëzimin seksual të fëmijëve;

7. Përdorimi i shpërndarjes së kontrolluar për zbulimin e trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave të përdorura në prodhimin e tyre dhe çdo substancë tjetër të ndaluar;

8. Çdo informacion tjetër përkatës i rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 4

Shkëmbimi i përvojave

Palët shkëmbejnë përvoja, në lidhje me luftën kundër krimeve dhe fenomeneve specifike në fushat e bashkëpunimit, sipas kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht në fushat e mëposhtme:

1. Mënyra e re e veprimtari të përdorur në kryerjen e krimeve dhe teknikat e reja në luftën ndaj krimeve;

2. Përdorimi i paligjshëm i drogave të dyshuara si mjete të përdorura në kontrabandimin e tyre, si dhe metodat e fshehjes dhe rrugët e kontrabandimit, llojet e reja të materialeve të përdorura në prodhim dhe teknikat moderne të përdorura në prodhimin, si dhe teknikat dhe pajisjet moderne që përdoren në zbulimin dhe ekzaminimin;



3. Përvoja praktike dhe shkencore në lidhje me fushat e bashkëpunimit;

4. Sistemet teknologjike dhe zgjidhjet e sigurisë që lidhen me fushat e bashkëpunimit;

5. Legjislacioni dhe tekstet ligjore përkatëse, si dhe kërkimet shkencore;

6. Praktikat më të mira në fushën e sigurisë dhe policisë;

7. Bashkëpunimi dhe koordinimi në aktivitete ndërkombëtare për tema të rëndësishme;

8. Çdo temë tjetër e rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 5 Trajnimi

Palët do të punojnë në kurse dhe programe të përbashkëta trajnimi që do të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të personelit të tyre në parandalimin dhe kontrollin e krimit dhe fenomeneve kriminale të përfshira në këtë marrëveshje, veçanërisht në temat e mëposhtme:

1. Zbulimi i metodave kriminale;
2. Përdorimi i teknologjive moderne për zbulimin dhe luftimin e krimeve;
3. Metodatat moderne të hetimit;
4. Forcimi i aftësive të mbrojtjes civile, shuarjes së zjarrit dhe kërkim-shpëtimit;
5. Fushën e asgjësimit të eksplozivëve;
6. Menaxhimi i emergjencave, krizave dhe fatkeqësive, brenda juridiksionit të të dyja palëve;
7. Çdo temë tjetër e rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 6 Bashkëpunimi i ardhshëm

Kjo Marrëveshje nuk i pengon palët të zhvillojnë forma të tjera të bashkëpunimit të përbashkët, duke marrë parasysh parashikimet e nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7 Kërkesa për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të informacionit

1. Në varësi të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi do të bëhet me kërkesë nga secila palë.

2. Kërkesa zyrtare për bashkëpunim bëhet me shkrim, por në raste urgjente ajo mund të bëhet me çdo mjet komunikimi të sigurt, për të cilin do të bihet dakord reciprokisht me kusht që të konfirmohet me kërkesë zyrtare brenda 3 ditëve. Nëse lind ndonjë dyshim në lidhje me vërtetësinë ose përmbajtjen e kërkesës, mund të kërkohet konfirmim shtesë i saj.

3. Kërkesat zyrtare për bashkëpunim duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e autoritetit kërkues dhe emrin e të kërkuarit nëse dihet;
- b) qëllimin dhe arsyet e kërkesës;
- c) një përshkrim të bashkëpunimit të kërkuar;
- d) çdo informacion shtesë që mund të ndihmojë siç duhet në ekzekutimin e kërkesës për bashkëpunim.

4. Kërkesat për bashkëpunim duhet të nënshkruhen nga autoriteti kompetent i palës kërkuese.

Neni 8 Refuzimi i kërkesës

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, për të ekzekutuar ndonjë kërkesë të bërë në përputhje me këtë marrëveshje, nëse ekzekutimi i një kërkesë të tillë mund të cenoj sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e saj ose detyrimet ndërkombëtare.

2. Kërkesa për bashkëpunim mund të refuzohet nëse veprimi, në lidhje me të cilin kërkesa u dërgua, nuk është i ndëshkueshëm sipas ligjit të shtetit të palës së kërkuar.

3. Pala e kërkuar do të njoftojë menjëherë palën kërkuese të arsyet e refuzimit.

Neni 9 Ekzekutimi i kërkesës

1. Pala e kërkuar do të ndjekë procedurat e nevojshme për të siguruar në mënyrë urgjente dhe të plotë ekzekutimin e kërkesës. Pala kërkuese do të informohet menjëherë për rrethanat që mund të pengojnë ose shkaktojnë ndonjë vonesë në ekzekutimin e kërkesës.

2. Pala e kërkuar mund të kërkojë informacion shtesë, i cili mund të konsiderohet i nevojshëm për të ekzekutuar kërkesën.



3. Pala e kërkuar, nëse ka ndonjë arsye, mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës ose përcaktimin e kushteve specifike për ekzekutimin e saj. Nëse pala kërkuese bie dakord për kushte të tilla, ajo do t'iu përmbahet atyre.

4. Pala e kërkuar, me kërkesë të palës kërkuese, do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e kërkesës, përmbajtjes, bashkëlidhjet e saj, si dhe atë në lidhje me bashkëpunimin e dhënë. Nëse nuk është e mundur të ekzekutohet kërkesa pa ruajtur konfidencialitetin, pala e kërkuar do të informojë palën kërkuese, e cila më pas do të vendosë nëse është e pranueshme për të ekzekutimi i kërkesës në kushte të tilla.

5. Pala e kërkuar do të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur palën kërkuese për rezultatin e ekzekutimit të kërkesës.

Neni 10

Kërkesa për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të përvojave dhe trajnimeve

Kërkesa për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të ekspertizës dhe trajnimit do të shkruhet nga autoritetet kompetente në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që procedurat dhe kostot për zbatimin e kërkesës të jenë dakordësuar nga të dyja palët, ashtu si ato e gjykojnë të arsyeshme.

Neni 11

Rregullat e përdorimit të informacionit dhe dokumenteve të marra

1. Palët nuk do të lejojnë përdorimin ose lëshimin e ndonjë informacioni ose dokumenti të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në kërkesë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

2. Informacioni i marrë nga secila palë nuk do t'i zbulohet asnjë pale të tretë pa pëlqimin me shkrim të palës tjetër.

Neni 12

Shpenzimet e ekzekutimit

Pala e kërkuar do të mbulojë shpenzimet e zakonshme të ekzekutimit të kërkesës për bashkëpunim sipas kësaj marrëveshjeje. Megjithatë,

nëse ekzekutimi i një kërkesë të tillë kërkon shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme, palët do të këshillohen për të vendosur termat dhe kushtet në të cilat bashkëpunimi i kërkuar mund të sigurohet.

Neni 13

Gjuha

Një kërkesë për bashkëpunim, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet në gjuhën shqipe ose në gjuhën arabe, të përkthyer në anglisht.

Neni 14

Takimet dhe konsultimet

Përfaqësuesit e palëve, kur është e nevojshme, do të mbajnë takime pune dhe konsultime për të diskutuar rezultatet e bashkëpunimit dhe masat për të përmirësuar efikasitetin e tij.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të një mosmarrëveshjeje që lind ose lidhet me këtë Marrëveshje, ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e saj, palët do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pëlqim të ndërsjellë nëpërmjet negociatave dhe konsultimeve në mirëbesim ose bazuar në një marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve.

2. Gjatë periudhës së mosmarrëveshjes, palët janë të detyruara të zbatojnë të gjitha detyrimet e tyre të përcaktuara në këtë marrëveshje.

3. Mosmarrëveshja që lind nga kjo Marrëveshje nuk do t'i nënshtrohet asnjë ligji ndërkombëtar ose kombëtar, as nuk do t'i nënshtrohet juridiksionit të një gjykate kombëtare, të huaj ose ndërkombëtare, ose ndonjë pale të tretë.

Neni 16

Marrëdhënia me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo marrëveshje nuk do të cenoj bashkëpunimin juridik dhe gjyqësor ndërmjet palëve në ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, që janë objekt i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare.



2. Kjo marrëveshje nuk do të paragjykojë të drejtat ose detyrimet e Palëve që dalin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për të cilat janë palë.

Neni 17

Autoritetet kompetente për bashkëpunim

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi do të bëhet përmes autoriteteve të mëposhtme:

a) Për Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Brendshme;

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

- Drejtoria e Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për rastet kundër terrorizmit që lidhen ndërmjet dy shteteve;

b) Për Emiratet e Bashkuara Arabe:

- Ministria e Brendshme;

- Administrata e Përgjithshme e Policisë Federale Kriminale; Departamenti i Sigurimit të Shtetit/në lidhje me krimet e sigurisë së shtetit, rastet e terrorizmit dhe krimet që lidhen me armët e shkatërrimit në masë dhe armët jokonvencionale;

- Shërbimi Informativ Kombëtar/në lidhje me krimet që lidhen me sigurinë e jashtme të shtetit, rastet e terrorizmit dhe organizatat e paligjshme.

2. Në rast të ndonjë ndryshimi në autoritetet e sipërpërmendura, palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

3. Palët, kur është e nevojshme, do të identifikojnë pikat e kontaktit direkt dhe kanalet e komunikimit.

Neni 18

Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit ndërmjet dy palëve për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet - në çdo kohë - me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve dhe do t'i nënshtrohet të njëjtave procedura në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar dhe secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, me

një njoftim me shkrim dërguar palës tjetër, gjashtë muaj përpara, përmes kanaleve diplomatike, pa paragjykuar zbatimin e kërkesave të paraqitura përpara atij njoftimi dhe mbetet subjekt i kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Dubai, më 28.3.2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën arabe, shqipe dhe angleze. Të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti anglisht do të mbizotërojë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Z. Bledar Çuçi
Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E EMIRATEVE
TË BASHKUARA ARABE

Gjen. Lt. Saif Bin Zayed Al Nahyan
Zëvendëskryeministër dhe Ministër
i Brendshëm

DEKRET

Nr. 13854, datë 27.9.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 66/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



LIGJ
Nr. 67/2022

PËR RATIFIKIMIN E
MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E BRENDSHME E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË
BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE
DHE IRLANDËS SË VERIUT, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
PUNËVE TË BRENDSHME, PËR
SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT PËR
QËLLIME TË LIDHURA ME
MIGRACIONIN

Në mbështetje të neneve 78, 83 e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për shkëmbimin e informacionit për qëllime të lidhura me migracionin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.9.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13855, datë 27.9.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
BRENDSHME E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERIA E
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË
VERIUT, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT
PËR QËLLIME TË LIDHURA ME
MIGRACIONIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në vijim të referuar bashkërisht si “Pjesëmarrësit” dhe individualisht si “Pjesëmarrësi”,

duke pasur parasysh marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të imigracionit në Republikën e Shqipërisë dhe Mbretërinë e Bashkuar;

me dëshirën për të forcuar më tej bashkëpunimin dypalësh dhe veprimin e përbashkët në luftën kundër migracionit të paligjshëm, për të reduktuar krimet e tjera ndërkufitare dhe për të forcuar administratën civile përgjegjëse për kontrollet e imigracionit;

duke pranuar që shkëmbimi i informacioni me objektiv të mirëpërcaktuar mbështet masat kundër migracionit të paligjshëm dhe përpjekjet për sigurinë e kufijve dhe për zbatimin e ligjit, dhe krijon mundësi për ndërtimin e kapaciteteve, nëpërmjet forcimit të lidhjeve përmes rritjes së bashkëpunimit për çështjet e lidhura me imigracionin; dhe

duke pranuar që çdo shkëmbim informacioni duhet të kryhet në pajtim me legjislacionin, rregulloret dhe politikat e çdo vendi në lidhje me imigracionin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe që duhet të merren masat e duhura mbrojtëse për të mbrojtur informacionin që shkëmbehet;

kanë rënë dakord si më poshtë:

1. Qëllimi

1.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi synon shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë të dhënat personale, ndërmjet Pjesëmarrësve, për



çështje lidhur me migracionin, për të ndihmuar Pjesëmarrësit në ruajtjen e kontrolleve efikase për migracionin.

1.2 Shkëmbimi i këtij informacioni është një komponent i nevojshëm për ruajtjen e kontrolleve efikase për migracionin që për Pjesëmarrësit përbën interes të rëndësishëm publik dhe ndihmon në forcimin e kufijve tanë përkatës.

1.3 Shkëmbimi i informacionit në lidhje me kriminalitetin, në zbatim të paragrafit 2.2, duhet të jetë në interesin thelbësor publik të Pjesëmarrësve.

2. Të përgjithshme

2.1 Sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë të dhëna personale, duke përfshirë të dhënat personale për shtetasit e tyre.

2.2 Në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, qëllimet lidhur me migracionin nënkuptojnë mënyrën e rregullimit se në cilat raste dhe mbi cilat baza ndonjë person mund të udhëtojë, hyjë apo qëndrojë në një nga vendet Pjesëmarrëse; dhe mbështetjen e përpjekjeve për të parandaluar ose ndjekur penalisht tentativat që pengojnë ose shmangin kontrollin e imigracionit, përfshirë ndjekjet penale për veprimtari të lidhura me të. Sipas rastit dhe në kuadër të veprimtarisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, kjo e fundit mund të përfshijë informacion lidhur me veprimtaritë në luftën kundër terrorizmit, sigurisë kombëtare ose kriminalitetit, të cilat janë objekt i angazhimit dhe bashkëpunimit me agjencitë e tjera përkatëse partnere.

2.3 Asnjë parashikim i këtij Memorandumi Mirëkuptimi, duke përfshirë përfundimin e tij nëse ndodh, nuk synon të cenojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet Pjesëmarrësve sipas marrëveshjeve ose rregullimeve të tjera, me kusht që informacioni i shkëmbyer sipas këtyre rregullimeve të jetë shkëmbyer në një mënyrë të pajtueshme me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

2.4 E gjithë veprimtaria sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të kryhet në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse të legjislacioneve të brendshme të Pjesëmarrësve dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare.

2.5 “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në veçanti duke iu referuar një

numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo shoqëror.

2.6 “Migracion i paligjshëm” i referohet udhëtimit për në territorin ose nga territori, dhe periudhave apo qëllimit të qëndrimit brenda territorit të secilit pjesëmarrës, të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin e atij Pjesëmarrësi, duke përfshirë sjelljen jo në përputhje me ligjet e vendit transit gjatë udhëtimit për në territorin e njërit prej Pjesëmarrësve;

2.7 “Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.

3. Procedurat për shkëmbimin e informacionit

3.1 Çdo shkëmbim informacioni duhet të jetë në përputhje me qëllimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe shkëmbimi do të kryhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale ndërmjet Pjesëmarrësve.

3.2 Pjesëmarrësit synojnë të shkëmbejnë informacion që lidhet me migracionin, nëse Pjesëmarrësi që e jep informacionin ka baza të arsyeshme dhe të vërteta për të besuar se dhënia e informacionit është e nevojshme për Pjesëmarrësin që e merr atë, me qëllim që të realizojë qëllimet në lidhje me migracionin, të përcaktuara në paragrafin 2.2.

3.3 Çdo Pjesëmarrës do të përcaktojë nëse informacioni që ka është i përshtatshëm për t’u shkëmbyer me Pjesëmarrësin tjetër dhe që shkëmbimi lejohet nga legjislacioni i brendshëm i Pjesëmarrësit dhe nga detyrimet ndërkombëtare.

3.4 Nëse pas marrjes së informacionit të shkëmbyer, Pjesëmarrësi që e merr informacionin konstaton informacione shtesë që mund të ndajë mbi subjektin për të cilin shkëmbehen të dhënat, ai do t’ia japë atë informacion Pjesëmarrësit tjetër, në përputhje me legjislacionin e brendshëm përkatës dhe detyrimet ndërkombëtare.

3.5 Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë informacion në mënyrë proaktive dhe/ose në përgjigje të një kërkesë nga Pjesëmarrësi tjetër. Çdo kërkesë e tillë bëhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, me shkrim ose me postë elektronike, dhe duhet të përmbajë arsye të mjaftueshme që mundësojnë që Pjesëmarrësi tjetër të përcaktojë ligjshmërinë e nxjerrjes së këtij informacioni.

3.6 Në përputhje me dispozitat e seksionit 5 më poshtë, çdo Pjesëmarrës duhet të përpiqet të



sigurojë informacionin e kërkuar nga Pjesëmarrësi tjetër në kohën e duhur, në masën që është e mundur.

3.7 Asnjë Pjesëmarrës nuk do të shkëmbejë të dhëna personale nëse ekziston rrezik që ky informacion mund të përdoret për të shkelur detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

3.8 Pjesëmarrësit nuk do të shkëmbejnë informacion, nëse shkëmbimi, përdorimi apo zbulimi i këtij informacioni mund: i. të shkaktojë që informacioni t'i zbulohet ndonjë qeverie, autoriteti apo individ të një pale të tretë nga i cili subjekti i informacionit kërkon apo i është dhënë mbrojtje sipas Konventës së vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit të saj të vitit 1967 për Statusin e Refugjatëve, Konventës së vitit 1984 kundër Torturës, Dënimit dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1976 ose sipas legjislacionit të brendshëm të Pjesëmarrësve, i cili zbaton Konventat apo Protokollin përkatës; ii. t'i japë mundësi subjektit të informacionit që me marrjen e informacionit nga Pjesëmarrësi, të fitojë të drejtën për mbrojtjen e specifikuar më lart; ose iii. ta vendosë subjektin e informacionit apo/dhe familjen e tij/saj në rrezik serioz, duke përfshirë dëbimin me forcë, përndjekjen, torturën apo çdo lloj tjetër lëndimi që parashikohet në Konventën e vitit 1951, Protokollin e vitit 1967, Paktin e vitit 1976 apo Konventën kundër Torturës.

4. Caktimi i oficerëve ndërlidhës

4.1 Çdo Pjesëmarrës duhet të caktojë oficerë ndërlidhës në autoritetin përgjegjës të Pjesëmarrësve, që autorizohen të shkëmbejnë informacion sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe të njoftojnë me shkrim ose me postë elektronike Pjesëmarrësin tjetër, në lidhje me caktimin apo ndryshimin e oficerëve ndërlidhës. Shkëmbimi i informacionit dhe përgjigjet ndaj kërkesave të bëra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi komunikohen ndërmjet këtyre oficerëve ndërlidhës të caktuar si pika qendrore kontakti për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Pjesëmarrësve.

4.2 Çdo Pjesëmarrës duhet të emërojë një oficer ndërlidhës, që është përgjegjës për të garantuar zbatimin dhe funksionimin e dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

4.3 Oficerët Ndërlidhës do të kryejnë bashkërisht analiza gjashtëmujore dhe do të përgatisin një raport me gjetjet e tyre, i cili do t'i paraqitet titullarit përkatës të çdo autoriteti të Pjesëmarrësve.

4.4 Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë çdo vit veprimtarinë e shkëmbimit të informacionit sipas këtij rregullimi, me qëllim që të garantojnë se ky Memorandum Mirëkuptimi vijon të plotësojë qëllimin e tij strategjik.

5. Informacioni që mund të shkëmbehet

5.1 Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë informacion duke përdorur mekanizma të sigurt që mund të lidhen me sa më poshtë, por nuk kufizohen vetëm me:

- Migracionin e paligjshëm;
- Lëvizjen e paligjshme të organizuar të njerëzve;
- Falsifikimin dhe mashtrimin me dokumentet në lidhje me imigracionin; dhe
- Veprimtarinë që lidhet me migracionin e paligjshëm të shtetasve të vendeve të Pjesëmarrësve.

5.2 Informacioni mund të shkëmbehet sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi vetëm në masën që është i rëndësishëm, i nevojshëm dhe i përshtatshëm për qëllimet e Pjesëmarrësve në lidhje me migracionin dhe aq sa lejohet nga legjislacioni i brendshëm dhe detyrimet ndërkombëtare të Pjesëmarrësve.

5.3 Pjesëmarrësit duhet të shkëmbejnë informacion vetëm në masën që ky informacion është në dispozicion të tyre dhe për aq kohë sa përhapja e informacionit është e mundur. Llojet e të dhënave që mund të shkëmbehen, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen domosdoshmërisht me:

- ndihmësit e njohur dhe të dyshuar;
- pasagjerë që mbërrijnë me dokumente të pamjaftueshme dhe detajet e tyre të rezervimit për udhëtim;
- adresa të strehëve të sigurta dhe të tjera të ngjashme;
- detaje të automjeteve;
- numra telefoni;
- identitete të tjera/aliase; dhe
- skanime të dokumenteve të udhëtimit dhe numra të dokumenteve të udhëtimit.

5.4 Është e qartë se një Pjesëmarrës nuk është i lirë të shkëmbejë informacion në rastin kur



përdorimi ose transferimi i atij informacioni kufizohet me ligj, ose nga kufizime apo konsiderata të tjera të brendshme, ose i nënshtrohet pëlqimit të një subjekti tjetër (qoftë pëlqimit të një subjekti të të dhënave, ose të një autoriteti ose personi tjetër).

5.5 Përdorimi i informacionit të shkëmbyer dhe kufizimet mbi të i nënshtrohen shqyrtimit të mëtejshëm dhe diskutimit konstruktiv ndërmjet Pjesëmarrësve.

6. Përdorimi i lejuar dhe përhapja e informacionit

6.1 Sipas paragrafëve 7.2 dhe 7.5, secili Pjesëmarrës mund ta përdorë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi, për cilëndo prej çështjeve që lidhen me migracionin, siç parashikohet në paragrafin 2.2, duke përfshirë procedurat përkatëse gjyqësore. Për këto qëllime, secili Pjesëmarrës mund t'ia përcjellë këtë informacion autoriteteve të tjera të brendshme, përgjegjëse për përmbushjen e qëllimeve, të cilave ky informacion u nevojitet për përmbushjen e detyrave të tyre zyrtare, duke përfshirë autoritetet që përfshihen në përcaktimin e ligjshmërisë së një subjekti të të dhënave për marrjen e përfitimeve apo shërbimeve publike që lidhen me statusin e imigracionit të subjektit të të dhënave. Pjesëmarrësit duhet të garantojnë që këto autoritete zbatojnë një nivel të mbrojtjes së informacionit dhe kufizojnë përdorimin dhe përhapjen e informacionit në të njëjtën mënyrë që pritet nga Pjesëmarrësit, sipas dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

6.2 Sipas paragrafëve 7.2 deri 7.5 (dhe veçanërisht paragrafit 7.3), nëse informacioni për identitetin dhe/ose dokumentin e identitetit, i shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, specifikon se një subjekt i të dhënave mund të jetë shtetas, ose të ketë status, ose të ketë një lidhje të përcaktuar qartë me një vend të tretë, secili nga Pjesëmarrësit, në masën e lejuar sipas legjislacionit të tij të brendshëm, mund t'ua zbulojë atë informacion autoriteteve përkatëse të atij vendi, për qëllime të verifikimit të identitetit të subjektit të të dhënave dhe/ose përcaktimit të origjinës së dokumenteve të identitetit në lidhje me ridokumentimin dhe/ose kthimin e subjektit të të dhënave në atë vend.

7. Kufizime mbi përdorimin dhe përhapjen e informacionit

7.1 Përhapja ose përdorimi i informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi për çdo qëllim ose për çdo person të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafin 6.1, kërkon miratimin paraprak më shkrim të Pjesëmarrësit që ka dhënë informacionin.

7.2 Çdo përdorim ose përhapje informacioni të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të respektojë legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe detyrimet ndërkombëtare të Pjesëmarrësit që e merr informacionin.

7.3 Specifikisht, asnjë Pjesëmarrës nuk duhet të shkëmbejë, përdorë ose përhapë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, informacion i cili mund t'i vihet në dijeni një qeverie, autoriteti apo personi ndaj të cilit subjekti i të dhënave mbrohet sipas Konventës së vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve, Protokollit të saj të vitit 1967, Konventës kundër Torturës, Dënimit dhe Trajtimeve të tjera Më të Dëmshme, Çnjerëzore ose Poshtëruese, ose sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose sipas legjislacionit të brendshëm të Pjesëmarrësit në zbatim të konventave apo protokolleve përkatëse. Asnjë Pjesëmarrës nuk duhet të shkëmbejë, përdorë ose përhapë informacion tek një qeveri, autoritet apo person, në rrethanat kur në bazë të marrjes së këtij informacioni nga ana e qeverisë, autoritetit ose personit, subjekti i informacionit mund të përfitojë të drejtën për një mbrojtje të tillë.

7.4 Çdo Pjesëmarrës, në një rast të veçantë, me anë të një shenje mbrojtëse ose shenje tjetër, mund të zbatojë kufizime shtesë në lidhje me përdorimin ose përhapjen e informacionit që ka dhënë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, i cili përfshin garantimin që trajtimi i informacionit është në përputhje me politikën, legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe detyrimet ndërkombëtare. Kur ndodh kjo, Pjesëmarrësi tjetër duhet t'i respektojë këto kufizime. Këto kufizime nuk mund të pengojnë aksesin e subjektit siç parashikohet nga paragrafi 10.5.

7.5 Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk synon të pengojë përdorimin ose përhapjen e informacionit rast pas rasti, në masën që ekziston një detyrim për ta bërë këtë sipas ligjeve të Pjesëmarrësit që e merr informacionin. Sipas kësaj dhe në masën që është e zbatueshme, një Pjesëmarrës duhet të njoftojë



Pjesëmarrësin tjetër paraprakisht për çdo përdorim ose përhapje të informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi, i cili nuk është në përputhje me dispozitat e Memorandumit të Mirëkuptimit. Gjithashtu, Pjesëmarrësi që e merr informacionin pritët që fillimisht të kërkojë leje me shkrim nga Pjesëmarrësi që e jep informacionin, nëse dëshiron t'ia zbulojë një informacion të tillë subjektit të të dhënave; një gjykatë, duke përfshirë çdo gjykatë administrative; ose ndonjë Pjesëmarrësi të tretë, përfshirë shtetet e treta dhe subjektet e tjera. Me anë të kësaj, Pjesëmarrësve u jepet mundësia, sipas rastit, të kërkojnë mospërhapje ose mbrojtje tjetër të informacionit, në masën që e lejon legjislacioni i Pjesëmarrësit që e merr informacionin.

8. Transferimi i informacionit

8.1 Shkëmbimi i informacionit sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të kryhet në mënyrë të sigurt ndërmjet oficerëve ndërlidhës. Proceset, formatet dhe metodat për shkëmbimin e të dhënave duhet të jenë në përputhje, kudo që është e zbatueshme, me çdo standard dhe proces që mund të vendoset bashkërisht nga Pjesëmarrësit.

8.2 Informacioni i transferuar ndërmjet Pjesëmarrësve në rrugë elektronike duhet të jetë i koduar sipas një standardi të miratuar, kur është e mundur.

8.3 Në rast se transferimi elektronik i sigurt nuk është i disponueshëm, një Pjesëmarrës mund të marrë masa që një nga oficerët e tij ndërlidhës t'ia dorëzojë informacionin personalisht një oficeri ndërlidhës të caktuar të Pjesëmarrësit tjetër.

9. Siguria e informacionit

9.1 Çdo Pjesëmarrës duhet të zbatojë masa për autentifikimin, me qëllim që të garantohet kufizimi i aksesit në informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Çdo Pjesëmarrës pritët ta kufizojë aksesin në informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi tek personeli i autorizuar që duhet të vihet në dijeni të informacionit për të kryer detyrat e tyre zyrtare, për përdorime në përputhje me qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

9.2 Çdo Pjesëmarrës duhet të garantojë që informacioni i marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk shpërndahet në mënyrë të paautorizuar.

9.3 Informacioni i shkëmbyer duhet të mbrohet me masa administrative, teknike dhe fizike të

përshtatshme për sensitivitetin e informacionit. Të dy Pjesëmarrësit duhet që gjithmonë të ruajnë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në një sistem elektronik dhe/ose manual të sigurt për ruajtjen.

9.4 Të gjithë personat që kanë akses në informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të jenë të arsimuar dhe të trajnuar, në lidhje me trajtimin dhe kufizimet për përdorimin e këtij informacioni, me qëllim që të sigurohet ruajtja e plotë e informacionit dhe zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

10. Integriteti i informacionit

10.1 Informacioni i dhënë dhe i marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, për qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Një Pjesëmarrës nuk mund të modifikojë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi pa autorizimin paraprak me shkrim të Pjesëmarrësit që e ka dhënë informacionin.

10.2 Nëse një Pjesëmarrës vihet në dijeni se informacioni që ka dhënë ose që ka marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi është i pasaktë, ai Pjesëmarrës duhet të njoftojë Pjesëmarrësin tjetër lidhur me këtë dhe të mundësohet dhënia e informacionit të saktë.

10.3 Çdo informacion i dhënë nga një Pjesëmarrës duhet të përfshijë detaje të atribuimit; datën e krijimit; klasifikimin e sigurisë dhe kufizimet ose lejet për përdorimin e mëtejshëm, me qëllim që të ndihmohen përpjekjet e arsyeshme për të mbajtur të saktë, të plotë dhe të përditësuar informacionin e shkëmbyer dhe për të garantuar trajtimin dhe përdorimin e tij në formën e duhur.

10.4 Pjesëmarrësit pritët që të marrin në kohë masat e duhura në lidhje me çdo kërkesë të bërë nga Pjesëmarrësi tjetër për akses, shtesa, ndryshime, fshirje ose korrigjime në informacionin e dhënë, duke përfshirë shkatërrimin e të dhënave në rastet kur është e përshtatshme.

10.5 Çdo Pjesëmarrës konfirmon se mban një sistem të aksesueshëm nga individë që pavarësisht nga kombësia ose vendi i tyre i qëndrimit, i lejon individët të kërkojnë informacione rreth tyre të cilat janë marrë në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe të kërkojnë korrigjimin ose shënimin e atij informacioni. Çdo Pjesëmarrës konfirmon gjithashtu se ofron mundësi korrigjimi për personat që kërkojnë një akses, korrigjim ose



shënim të tillë, pavarësisht nga kombësia ose vendi i tyre i qëndrimit.

11. Mbajtja e informacionit

11.1 Çdo Pjesëmarrës duhet të vlerësojë përshtatshmërinë e vazhdueshme të informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi për qëllime që lidhen me migracionin dhe të asgjësojë informacionin në mënyrë të sigurt, kur ai nuk është më i nevojshëm për qëllimet e theksuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

11.2 Informacioni që ruhet në një dosje elektronike ose fizike në lidhje me një subjekt të të dhënave, për shkak se ka lidhje të vazhdueshme me atë dosje, mund të ruhet si pjesë e asaj dosjeje në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe politikat e mbajtjes së të dhënave të Pjesëmarrësit që e ka marrë informacionin.

11.3 Informacioni që vihet në listat e vëzhgimit, listat e monitorimit dhe listat e alertit/sinjalizimit ose që mbahet për përdorim të mundshëm në të ardhmen, mund të mbahet gjithashtu për sa kohë që lidhet me kontrollin e migracionit nga ai Pjesëmarrës, deri në një afat maksimal fillestar prej dhjetë vjetësh nga data e marrjes. Si pjesë e rishikimeve të vazhdueshme të këtij informacioni të hedhur, Pjesëmarrësit synojnë të diskutojnë miratimin, përpara periudhës dhjetëvjeçare, për informacionin që duhet të mbahet për një periudhë të mëtejshme.

11.4 Çdo informacion i mbajtur, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafët 11.1 deri 11.3 më sipër, i nënshtrohet miratimit paraprak më shkrim të Pjesëmarrësit që ka dhënë informacionin.

12. Njoftimet dhe mjetet juridike

12.1 Çdo Pjesëmarrës, për të siguruar masa të mëtejshme për privatësinë, sigurinë, konfidenialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të informacionit që ruan, përpunon dhe transmeton, duhet të njoftojë me shkrim Pjesëmarrësin tjetër, sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, por jo më vonë se 24 orë pasi të vihet në dijeni, për çdo shkelje të sigurisë së sistemeve të informacionit që përmbajnë informacion të shkëmbyer ose për çdo përdorim apo përhapje të paautorizuar të informacionit të shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

12.2 Pjesëmarrësit duhet të marrin masat e duhura sipas legjislacionit administrativ, civil dhe/ose penal, në rast keqpërdorimi, ndryshimi të

paautorizuar, fshirjes, aksesit të paautorizuar ose shpërndarjes së informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi nga punonjësit e tyre, agjentët ose ndonjë Pjesëmarrës i tretë.

13. Regjistrimi i veprimeve

13.1 Pjesëmarrësit duhet të regjistrojnë informacionin e dhënë dhe të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, duke përdorur një kuadër të vendosur bashkërisht. Kjo nuk cenon regjistrimet e tjera që ata mund të mbajnë në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm të zbatueshëm dhe politikat dhe udhëzimet për mbajtjen e të dhënave.

14. Pajtueshmëria dhe auditimi

14.1 Secili Pjesëmarrës mund të kërkojë garanci nga Pjesëmarrësi tjetër se janë në funksionim masa të mjaftueshme mbrojtëse në lidhje me informacionin e shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, i cili mund të përfshijë kërkesën për një auditim të masave mbrojtëse. Pjesëmarrësi prej të cilit kërkohet auditimi mund të rakordojë që auditimi të kryhet nga një audit i përshtatshëm, sipas termave të referencës që duhet të vendosen bashkërisht nga Pjesëmarrësit.

14.2 Pjesëmarrësit duhet të përpiqen të trajtojnë çdo mangësi në masat mbrojtëse pas një auditimi sipas paragrafit 14.1 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Megjithatë, nëse lind një situatë ku një Pjesëmarrës e çmon të nevojshëm të refuzojë shkëmbimin e informacionit të mëtejshëm sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në pritje të një vendimi për çështjen, duhet t'i dërgojë njoftim me shkrim Pjesëmarrësit tjetër. Ky njoftim duhet t'i nënshtrohet konsultimit të menjëhershëm ndërmjet Pjesëmarrësve.

15. Raportet për performancën dhe menaxhimin

15.1 Pjesëmarrësit duhet të përgatisin bashkërisht, çdo vit, një raport për vëllimin e informacionit të shkëmbyer; llojin e informacionit të shkëmbyer; rastet kur shkëmbimi dha një kontribut të dukshëm në vendimet e imigracionit dhe numrin e ndjekjeve penale të kryera si rezultat i shkëmbimeve. Raporti duhet të bazohet në masat e performancës dhe menaxhimit, të vendosura bashkërisht dhe duhet të përfshijë, por nuk kufizohet me numrin dhe shkallën e çdo shkeljeje të sigurisë/privatësisë së informacionit të shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, si edhe një përmbledhje të masave korrigjuese të



ndërmarra. Raporti i paraqitet Drejtorit përkatës të çdo Organizate.

16. Modifikimi dhe konsultimet

16.1 Pjesëmarrësit synojnë të informojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim në legjislacion, politika ose detyrimet e tyre përkatëse ndërkombëtare që mund të prekin funksionimin ose interpretimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

16.2 Pjesëmarrësit mund ta ndryshojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi herë pas here, siç vendoset bashkërisht me shkrim, dhe të bëjnë ndryshime në funksionimin e tij, siç parashikohet nga dispozitat e tij specifike, me kusht që këto modifikime dhe ndryshime të jenë në përputhje me qëllimin dhe natyrën fillestare të Memorandumit të Mirëkuptimit.

17. Zbatimi dhe interpretimi

17.1 Ky Memorandum shpreh mirëkuptimin e Pjesëmarrësve. Ai nuk synon të krijojë detyrime ligjore, as të krijojë ose t'i japë ndonjë të drejtë, privilegj ose përfitim ndonjë personi ose Pjesëmarrësi, qoftë privat ose publik.

17.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Pjesëmarrësve që lind nga interpretimi ose zbatimi i ndonjë aspekti të kësaj marrëveshjeje mund të zgjidhet me konsultim të ndërsjellë, pa iu referuar ndonjë Pjesëmarrësi të tretë ose gjykatës ndërkombëtare.

17.3 Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk duhet të cilësohet se pengon ndonjë nga Pjesëmarrësit të bashkëpunojë ose të japë ndihmë, në përputhje me dispozitat e traktateve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të zbatueshme, marrëveshjeve të tjera, ligjeve të brendshme dhe praktikave përkatëse.

18. Financimi

18.1 Pjesëmarrësit do të mbulojnë kostot e tyre dhe do të përdorin pajisjet dhe burimet e tyre njerëzore për kryerjen e veprimtarive të tyre sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

19. Fillimi dhe përfundimi

19.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas konfirmimit nga të dy Pjesëmarrësit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që Pala Shqiptare ka përfunduar të gjitha procedurat e brendshme që parashikohen në legjislacionin e saj për hyrjen në fuqi të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe që Mbretëria e Bashkuar është gati për zbatimin e tij. Memorandumi i Mirëkuptimit do të vazhdojë të

jetë në fuqi për një kohë të pacaktuar, përveç rastit kur përfundon sipas paragrafit 19.2.

19.2 Ndryshe nga sa parashikohet në paragrafin 19.1 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pjesëmarrja në këtë Memorandum Mirëkuptimi vazhdon deri në momentin që ose nëse njëri Pjesëmarrës nuk dëshiron më të vazhdojë veprimtaritë e tij sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet të bëhet 90 ditë përpara.

19.3 Nëse veprimtaritë nuk zhvillohen më, të dhënat që janë marrë nga Pjesëmarrësit mbahen për t'u përdorur dhe më pas asgjësohen, në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

19.4 Pjesëmarrësit rikonfirmojnë angazhimin e tyre për të punuar dhe shkëmbyer informacione në lidhje me imigracionin, sipas përcaktimit në këtë Memorandum Mirëkuptimi. Përveç rrethanave të tilla që specifikohen dhe kërkojnë vendim, sipas paragrafit 14.2 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, secili Pjesëmarrës duhet të vazhdojë me besnikëri këtë bashkëpunim në mënyrë të plotë.

Nënshkruar në _____, më _____.2022, në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze dhe shqipe, ku të dyja tekstet kanë vlefshmëri të barasvlershme.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E MBRETËRISË
SË BASHKUAR TË BRITANISË SË
MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT
**Në emër të Sekretarit për Punët
e Brendshme**

DEKRET
Nr. 13855, datë 27.9.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 67/2022, "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të



përfaqësuar nga Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për shkëmbimin e informacionit për qëllime të lidhura me migracionin”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**VENDIM
Nr. 71/2022**

**PËR MOSMIRATIMIN E NJË
KANDIDATURE PËR ANËTAR TË
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË NGA TRUPA E
PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË
DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR.
115/2016, “PËR ORGANET E
QEVERISJES SË SISTEMIT TË
DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zonjës Arta Mandro për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit të dytë në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatit për Anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar më datën 22.9.2022.

**VENDIM
Nr. 72/2022**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT PETRAQ
LIKA ANËTAR TË BORDIT TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Zoti Petraq Lika zgjidhet anëtar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar më datën 22.9.2022.

**VENDIM
Nr. 73/2022**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT EDMOND
TULLUMANI ANËTAR TË KËSHILLIT
DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT
SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Zoti Edmond Tullumani zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar më datën 22.9.2022.



VENDIM
Nr. 74/2022

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
67/2020, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË
PERSONELIT ME KOHË TË PLOTË
PUNE TË KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, shkronja “m”, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit të Kuvendit nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datën 22.9.2022.

Strukturë – Organigrama e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Lidhja 1





ORGANIKA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Lidhja 2

Nr.	Funksioni	Kategoria e pagave	Numri
1	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor, i ndryshuar	1
1.1	Kabineti i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve		
	Drejtor kabineti	I-a	1
	Këshilltar	Barazohet në pagë zv.ministri	2
	Zëdhënës	II-b	1
	Sekretare	Pika 6, VKM 187, datë 18.3.2017	1
1.2	Spektori i Auditit të Brendshëm		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
2	Nënkomisioner	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor, i ndryshuar	1
3	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1
4	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE		
	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1
4.1	Drejtoria e Administratës Zgjedhore		
	Drejtor drejtorie	II-b	1
4.1.1	Spektori i Koordinimit		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	4
4.1.2	Spektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajtimeve		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.2	Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit		
	Drejtor	II-b	1
4.2.1	Spektori i Materialeve Zgjedhore		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.2.2	Spektori i Zhvillimeve Digjitale		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	3
4.2.3	Spektori i Administrimit të Dhënave Digjitale		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.3	Drejtoria për Votimin nga Jashtë		



Nr.	Funksioni	Kategoria e pagave	Numri
	Drejtor drejtorie	II-b	1
4.3.1 Sektori i Koordinimit dhe Informimit			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.3.2 Sektori i Administrimit dhe Zhvillimit të Votimit			
	Specialist	III-b	3
4.4 Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit			
	Drejtor drejtorie	II-b	1
4.4.1 Sektori për Subjektet Zgjedhor dhe Dekriminalizimin			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.4.2 Sektori i Mbikëqyrjes Financiare dhe Monitorimit të Fushatës			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	3
5. DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE			
	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1
5.1 Drejtoria e Ligjshmërisë			
	Drejtor drejtorie	II-b	1
5.1.1 Sektori i Akteve dhe Konsulencës Ligjore			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	4
5.1.2 Sektori për Denoncimet, Ankimet dhe Sanksionet			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	3
5.2 Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit			
	Drejtor drejtorie	II-b	1
5.2.1 Sektori i Edukimit dhe Informimit			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
5.2.2 Sektori i Vëzhgimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar			
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
5.3 Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit			
	Drejtor drejtorie	II-b	1
	Specialist	III-b	4
5.4 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse			
	Drejtor drejtorie	II-b	1



Nr.	Funksioni	Kategoria e pagave	Numri
5.4.1	Spektori i Protokollit dhe Arkivës		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	4
5.4.2	Spektori i Burimeve Njerëzore		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
5.4.3	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
	Sekretare	Pika 6, VKM 187, datë 18.3.2017	3
	Receptionist	VKM nr. 234, datë 20.4.2022	1
	Teknik Fotokopjues	-II-	1
	Magaznier	-II-	1
	Postier	-II-	1
	Shofer	-II-	2
	Punëtor mirëmbajtës	-II-	1
	Punonjëse pastrimi	-II-	3
	Punonjës gjithsej		95

**VENDIM
Nr. 75/2022**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË
PAGAVE TË PERSONELIT ME KOHË JO
TË PLOTË PUNE, QË REKRUTOHET
PËR REALIZIMIN E PROCESIT
ZGJEDHOR PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2023
TË KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, shkronja “m”, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi me dekretimin e datës së zgjedhjeve.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar më datën 22.9.2022.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PART TIME 2023

DREJTORIA: BURIMEVE NJERËZORE

lidhja 1

Nr.	Njësia Përgjegjëse	Kategoria e pagës	Periodha e punësimit	Nr. punonjësve	Kriteret e Punësimit
1.	KABINETI KOMISIONERIT				
	Specialist (përkthyes gjuhës angleze)	IV-b	9 muaj	1	Arsim i lartë/ Anglisht ekpseriencë pune/përkthyes
	Specialist	IV-b	6 muaj	4	Arsim i lartë
	Operator/ kameraman	V	9 muaj	2	Arsim i detruar
	Operator/fotograf	V	6 muaj	1	Arsim i detruar
2.	NËNKOMISIONER				
	Specialist	IV-b	6 muaj	1	Arsim i lartë
3	DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE, EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE				
3.1	Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor				
3.1.1	Saktori i Përgatitjes se Akteve				
	Specialist	IV-b	6 muaj	10	Arsim i lartë /Jurist
	Specialist/Redaktor	IV-b	8 muaj	2	Arsim i lartë/Gjuhë letërsi shqipe
3.1.2	Saktori i Verifikimit të Dokumentave dhe Këshillimit Ligjor mbi Ankesat Administrative dhe Gjyqësore				
	Specialist/KAS /Denoncime	IV-b	6 muaj	20	Arsim i lartë /Jurist
3.1.3	Saktori i Dekriminalizimit				
	Specialist	IV-b	3 muaj	28	Arsim i lartë /Jurist
	Specialist	IV-b	3 muaj	2	Arsim i lartë /jurist/njohuri të mira në excel
4.1	Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm				
4.1.1	Saktori i Kontrollit Financiar				
	Specialist	IV-b	6 muaj	3	Arsim i lartë/Ekonomik
5.1	Drejtoria Buxhetit dhe Financës				
	Specialist	IV-b	6 muaj	8	Arsim i lartë/Ekonomik
6.1	Drejtoria e Burimeve Njerëzore				
6.1.1	Saktori i Administrimit dhe Arkivimit të Dokumentacionit				
	Specialist/Protokoli	IV-b	9 muaj	4	Arsim i lartë
	Specialist/Arkivi	IV-b	9 muaj	3	Arsim i lartë
	Specialist/Stenografë	IV-b	6 muaj	10	Arsim i lartë/ Gjuhë letërsi
	Operator/Protokoli	V	6 muaj	2	Arsim i detruar
	Operator/ Arkiv	V	9 muaj	3	Arsim i detruar
6.1.2	Saktori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse				
	Specialist /Marrëdhëniet e Punës	IV-b	6 muaj	2	Arsim i lartë
	Specialist /Shërbimet	IV-b	6 muaj	1	Arsim i lartë/Jurist
	Ndihmës/Magaziner	IV	8 muaj	2	Arsim i detruar
	Receptionist	III	6 muaj	2	Arsim i lartë
	Postier/fotokopierues	II	6 muaj	3	Arsim i detruar
	Teknik/salle	IV	6 muaj	1	Arsim i detruar
	Punonjës/pastrimi	I	9 muaj	5	Arsim i detruar
7.	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE				
7.1	Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore				
7.1.1	Saktori i Koordinimit dhe Mbikëqyrjes				
	Specialist	IV-b	6 muaj	4	Arsim i lartë
	Operator	V	6 muaj	2	Arsim i detruar
	Operator	V	2 muaj	4	Arsim i detruar
7.1.2	Saktori i Trajnimeve				
	Specialist redaktor	IV-b	6 muaj	2	Arsim i lartë/ Juridik/ gjuhë letërsi
	Specialist/trajnimi multimedia	IV-b	6 muaj	1	Arsim i lartë
7.1.3	Saktori i Mjeteve dhe Materialeve Zgjedhore				
	Specialist	IV-b	5 muaj	8	Arsim i lartë
	Specialist	IV-b	9 muaj	4	Arsim i lartë
	Specialist	IV-b	7 muaj	6	Arsim i lartë
	Punëtor Logjistike	III	12 muaj	2	Arsim i detruar
	Punëtor Logjistike	III	10 muaj	28	Arsim i detruar
	Punëtor Logjistike	III	3 muaj	41	Arsim i detruar
8.1	Drejtoria e Administrimit të Dhenave dhe Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit				
8.1.1	Saktori i Administrimit të të Dhenave dhe Sistemeve				
	Specialist /SADS	IV-b	6 muaj	8	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/shkenca kompiuterike
	Specialist /SADS	IV-b	3 muaj	7	Arsim i lartë/ Informatikë
	Operatorë /SADS	V	6 muaj	10	Arsim i detruar
	Operatorë /SADS	V	3 muaj	5	Arsim i detruar
	Operatorë /SADS	V	3 muaj	15	Arsim i detruar
	Operatorë /SADS	V	3 muaj	5	Arsim i detruar
	Specialist magazine IE	IV-b	6 muaj	18	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/shkenca kompiuterike
	Specialist trajnimi/IE	IV-b	8 muaj	2	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/shkenca kompiuterike
	Specialist Koordinimi ne Terren IE	IV-b	6 muaj	6	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/shkenca kompiuterike
	Specialist IT/IE	IV-b	6 muaj	4	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/shkenca kompiuterike
	Specialist mbikëqyrës operatorësh/IE	IV-b	6 muaj	18	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/shkenca kompiuterike
	Operatorë magazine /IE	V	6 muaj	10	Arsim i detruar/ preferohet profesional teknologji info
	Operatore magazine/ verifikim Pas-zgjedhor IE	V	2 muaj	10	Arsim i detruar/ preferohet profesional teknologji info
9.1	Drejtoria e Komunikimit				
9.1.1	Saktori i Programeve të Edukimit të Zgjedhësve				
	Specialist	IV-b	6 muaj	7	Arsim i lartë/ Juridik/ gazetari/ mësuesi
	Specialist	IV-b	8 muaj	1	Arsim i lartë/ Juridik/ gazetari/ mësuesi
9.1.2	Saktori për Vëzhgimin e Zgjedhjeve				
	Specialist	IV-b	6 muaj	4	Arsim i lartë/ Anglisht ekpseriencë pune/ përkthyes
	TOTAL			352	



VENDIM
Nr. 76/2022

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË
PAGAVE TË PERSONELIT ME KOHË JO
TË PLOTË PUNE, QË REKRUTOHET
PËR PËRPUNIMIN E MATERIALEVE
ZGJEDHORE, TË KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 19, shkronja “m”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për përpunimin e materialeve zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për përpunimin e materialeve zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datën 22.9.2022.

Lidhja 1

Njësitë përgjegjëse	Pozicioni i punës	Kategoria e pagës	Periudha e punësimit	Nr. i punonjësve	Kriteret e punësimit
	Punëtor logjistike	III	1 muaj	10	Arsim i detyruar
	Operatorë	V	1 muaj	5	Arsim i detyruar
	TOTALI			15	

VENDIM
Nr. 77/2022

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË
POSAÇËM PËR REFORMËN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë deri më 21 tetor 2022.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datën 22.9.2022.



VENDIM

Nr. 623, datë 28.9.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 688, DATË 18.11.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME
PAGË DHE SHTESA MBI PAGË PËR
PUNONJËSIT E GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikave 1, shkronja “a”, dhe 2, të nenit 48, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 688, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara me aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’, të ndryshuar”, në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

**PAGA MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
1	2	3
Për punonjësit e nivelit madhor	Drejtues Madhor	125.000
	Drejtues i lartë	115.000
Për punonjësit e nivelit të lartë	Drejtues i parë	109.000
	Drejtues	99.000
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Kryekomisar	87.000
	Komisar	77.000
	Nënkomisar	70.000
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor i parë	58.400
	Inspektor i dytë	55.700
	Inspektor	53.500



VENDIM
Nr. 624, datë 28.9.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 350, DATË 19.4.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA
MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË
SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikave 1, shkronja “a”, e 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 350, datë 19.4.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Lidhja nr. 1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT TË MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
1	2	3	4
Niveli bazë	Asistent Zjarrfikës	43000	7000
	Zjarrfikës	49000	8000
	Kryezjarrfikës	51500	8000
Niveli i mesëm	Inspektor Zjarrfikës	60000	6000
	Kryeinspektor Zjarrfikës	69500	6000
	Komisar Zjarrfikës	91000	6000
Niveli i lartë	Drejtues Zjarrfikës	101000	
	Drejtues i Parë Zjarrfikës	112000	
Niveli madhor	Drejtues i Lartë Zjarrfikës	123000	

a) Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në paragrafin e fundit, të pikës 3, pas fjalëve “... Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, ...” shtohen “... Policisë së Shtetit ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2022 për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në nivel qendror dhe në nivel vendor.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në nivel qendror, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë strukturat përkatëse të këtij shërbimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA X DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË*(kërkesat nr. 73548/17 dhe 45521/19)*

VENDIM

Neni 1 P12 – Ndalimi i diskriminimit – Moszbatimi i masave të menjëhershme dhe të detajuara kundër segregimit/veçimit në një shkollë fillore, e cila frekuentohet pothuajse ekskluzivisht nga fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian – Asnjë justifikim objektiv dhe i arsyeshëm

Neni 46 – Masa individuale – Shtetit të paditur i kërkohet që të marrë masa për t'i dhënë fund diskriminimit

STRASBURG

31 maj 2022

Ky vendim do të bëhet përfundimtar sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44§§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues

Në çështjen X dhe Të Tjerët kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Georges Ravarani, *kryetar,*

Georgios A. Serghides,

María Elósegui,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Andreas Zünd,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë,*

dhe Milan Blaško, *Sekretar i Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesat (nr. 73548/17 dhe 45521/19) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), në lidhje me datat e paraqitura në shtojcë nga tetëmbëdhjetë shtetas shqiptarë me origjinë etnike romë dhe egjiptian, të cilët përbëjnë gjashtë familje (“kërkuesit”), të cilët u përfaqësuan përpara Gjykatës nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (“QEDR”), një organizatë joqeveritare, me vendndodhje në Bruksel, Belgjikë.

vendimin për të mos i bërë publikë emrat e kërkuesve;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) për kërkesat. Qeveria u përfaqësua nga ish-agjentët e saj, z. A. Metani, znj. E. Muçaj, dhe më pas, nga z. O. Moçka nga Avokatura e Shtetit;

vërejtjet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe vërejtjet e dorëzuara nga kërkuesit si përgjigje e të parave;

komentet e paraqitura nga T’Reja Centre, një organizatë joqeveritare, me zyra qendrore në Tiranë, Shqipëri, së cilës iu dha leje që të ndërhynte nga Kryetari i Seksionit;

pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 10 maj 2022,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

HYRJE

1. Kërkesa ka të bëjë me diskriminimin e pretenduar ndaj kërkuesve, pasi Qeveria nuk zbatoi masat e menjëhershme dhe të detajuara kundër segregimit/veçimit në një shkollë fillore, e cila frekuentohej pothuajse ekskluzivisht nga fëmijë të minoritetit rom dhe egjiptian.

FAKTET

I. GJETJET E QEVERISË NË LIDHJE ME SHKOLLËN “NAIM FRASHËRI”

2. Kërkuesit jetojnë në Korçë, një qytet në juglindje të Shqipërisë me 76 000 banorë. Sipas të dhënave të qeverisë lokale, gjatë vitit akademik 2018/19, në sistemin e detyruar arsimor të këtij qyteti u regjistruan rreth 1200 fëmijë romë dhe egjiptianë.

3. Gjatë viteve akademike 2012/19, nxënësit romë dhe egjiptianë në shkollën fillore “Naim Frashëri” në Korçë përbënin rreth 89 deri në 100% të nxënësve në shkollë. Në vitin 2012, Qeveria kishte zbatuar një program për ndihmën ushqimore, sipas së cilit nxënësit që ndiqnin atë shkollë përfitonin pako me ushqime, me qëllimin që të rriteshin normat e frekuentimit të shkollës nga fëmijët e atyre komuniteteve. Kërkuesit fëmijë ndiqnin të njëjtën shkollë.

4. Në një rekomandim të përgjithshëm të datës 11 shtator 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (“Komisioneri” ose “Komisioneri kundër Diskriminimit”), një organ i brendshëm i themeluar sipas ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit (ligji nr. 10221, i datës 4 shkurt 2010), i rekomandoi Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (“Ministria”) të mbante në konsideratë raportin midis nxënësve romë/egjiptianë dhe të tjerë në



shkollë dhe të merrte masa për të shmangur krijimin e shkollave që ndiqeshin vetëm nga nxënësit e këtyre komuniteteve.

5. Më 3 korrik 2015, QEDR-ja paraqiti një ankesë pranë Avokatit të Popullit, që është një institucion i krijuar për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve ndaj autoriteteve publike, me pretendimin se mbipërfaqësimi i nxënësve romë/egjiptianë në shkollën “Naim Frashëri” krijonte veçim. Pasi çështja u mor në konsideratë dhe pasi u dëgjua opinionin e Ministrisë së mbipërfaqësimi në fjalë, vinte si një pasojë e paqëllimshme e programit për ndihmë ushqimore, më 12 gusht 2015, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë të merrte masa proaktive për t’i dhënë fund diskriminimit të nxënësve në fjalë. Gjithashtu, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë të krijonte një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të masave kundër segregimit në të gjitha shkollat.

6. Pas një ankese të ngjashme nga QEDR-ja dhe nga një organizatë tjetër, së cilave Ministria iu përgjigj se mbipërfaqësimi për të cilin drejtohej ankesa ishte i paqëllimshëm, më 22 shtator 2015, Komisioneri kundër Diskriminimit nxori një vendim detyrues ku konstatohej se fëmijët romë dhe egjiptianë në shkollën “Naim Frashëri”, po vuanin diskriminim jo të drejtpërdrejtë, për shkak të mbipërfaqësimit të tyre në shkollë.

7. Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës i cili ndalon diskriminimin (shih paragrafin 17 më poshtë) dhe vendimit të Gjykatës në çështjen *Lavida dhe të Tjerët kundër Greqisë* (nr. 7973/10, 30 maj 2013), Komisioneri konstatoi se vendosja e nxënësve romë në një shkollë të posaçme i veçon ata dhe nuk lejon integrimin e tyre në aktivitetet sociale gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë se Ministria ishte organi publik përgjegjës për pranimet në shkollë, Komisioneri theksoi se sipas nenit 7(1) të ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit (shih paragrafin 23 më poshtë), si veprimet edhe mosveprimet që kanë shkaktuar një shkelje të barazisë midis personave, mund të sjellin diskriminim. Së fundmi, Komisioneri theksonte se në mbështetje të nenit 18(1) të ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit (shih paragrafin 24 më poshtë), Këshilli i Ministrave dhe Ministria kishin detyrimin të merrnin masa pozitive kundër diskriminimit lidhur me të drejtën për t’u arsimuar.

8. Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri urdhëroi Ministrinë të merrte “masa të

menjëhershme për përmirësimin e situatës dhe të ndryshonte raportin” midis nxënësve romë/egjiptianë dhe nxënësve të tjerë në shkollë.

II. ZBATIMI I VENDIMIT TË KOMISIONERIT

9. Më 14 dhjetor 2015, Ministria informoi Komisionerin se do të ndërmerre një sërë masash kundër segregimit në shkollë, duke përfshirë zgjerimin e programit të ndihmës ushqimore për nxënësit e të gjitha komuniteteve edhe për katër shkolla të tjera në këtë zonë, si edhe bashkimin e shkollës “Naim Frashëri” me tri shkolla lokale.

10. Më 22 shkurt 2017, Qeveria zgjeroi programin për mbështetjen ushqimore për të gjithë nxënësit e shkollës “Naim Frashëri” (vendim i Këshillit të Ministrave nr. 132 i po së njëjtës datë).

11. Më 14 prill 2017, Ministria informoi QEDR se shkolla vijonte të frekuentohej pothuajse ekskluzivisht nga nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian. Në vijim, Ministria shpjegoi se duke qenë se viti akademik ishte në vijim, nuk ishte momenti i duhur që të zbatohesh bashkimi i shkollave të ndryshme, por i siguroi QEDR-së, se në fillim të vitit të ri akademik, në shtator, segregimi në shkollë do të përfundonte. Gjithashtu, Ministria deklaroi se do t’i kërkonte autoriteteve kompetente të organizonin rinovimin e shkollës.

12. Punimet për rinovim u realizuan gjatë vitit akademik 2018/19 dhe përfunduan në shtator 2019.

13. Më 6 nëntor 2019, Qeveria parashtroi përpara Gjykatës se për vitin akademik 2019/20, nxënësit romë/egjiptianë përbënin 90% të nxënësve në shkollën “Naim Frashëri”.

14. Më 25 shkurt 2020, Ministria informoi Avokatin e Shtetit se përqindja e nxënësve romë/egjiptianë në shkollë ishte 60%. Gjithashtu, Ministria pohonte se bashkimi i shkollës me shkollat e tjera pranë saj nuk ishte realizuar, për shkak të punimeve për rinovimin e shkollës.

15. Kërkuesit e kundërshtuan shifrën e mësipërme dhe parashtruan se në realitet, në shkollën “Naim Frashëri” ishin regjistruar shumë nxënës, që nuk i përkisnin komunitet rom/egjiptian, por më pas ata ndoqën shkollat fqinje.

III. ZHVILLIME TË TJERA

16. Më 16 dhjetor 2015, Komisioneri nxori një vendim në të cilin konstatohej se shkolla fillore “Avdyl Avdia” në Berat, ndiqet ekskluzivisht nga nxënës të komunitetit rom, fakt i cili përbënte



diskriminim dhe ishte në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen ndaj diskriminimit. Komisioneri i kërkoi Ministrisë të merrte masa për transportin dhe frekuentimin e nxënësve të shkollës në një shkollë tjetër pranë shkollës “Avdyl Avdia”. Në korrespondencën e datës 14 prill 2017 me QEDR-në (shih paragrafin 11 më sipër), Ministria pohonte se shkolla “Avdyl Avdia” ishte mbyllur në mbështetje të vendimit të Komisionerit, dhe çështja e transportit po adresohet nga bashkia në fjalë.

KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA PËRKATËSE

I. LIGJET E BRENDSHME

A. Kushtetuta

17. Neni 18 i Kushtetutës parashikon, si më poshtë:

“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”

18. Neni 57 parashikon se kushdo ka të drejtën për arsimim.

B. Ligji për arsimin 2012 (ligji nr. 69/2012 i datës 21 qershor 2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë)

19. Parimet e përgjithshme të zbatueshme në institucionet arsimore parashikohen në nenin 6 të ligjit për arsimin të vitit 2012. Paragrafi 4 i atij neni parashikon:

“Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.”

C. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, 2010

20. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (ligji nr. 10221 i datës 4 shkurt 2010), i cili ishte në fuqi përpara ndryshimit të tij me anë të ligjit nr. 124/2020, të datës 15 tetor 2020, parashikonte parimin e barazisë përpara ligjit, për sa i takonte gjinisë, racës, etnisë së kujtdo dhe një sërë aspektesh të tjera (neni 1).

21. Neni 3 (3) i ligjit e përcaktonte “diskriminimin e tërthortë” si një formë diskriminimi, i cili ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të

favorshme, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

22. Neni 3 (9) i ligjit e përkufizon termin “organizatat me interesa legjitimë” si ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit. Neni 33 (1) i ligjit parashikon se një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit.

23. Neni 7(1) i ligjit parashikon:

“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

24. Neni 18 (1) i ligjit parashikon:

“Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.”

25. Nenet 21 dhe 22 të ligjit parashikojnë krijimin e institucionit të Komisionerit kundër Diskriminimit si një autoritet publik i pavarur i ngarkuar me detyrën për të garantuar mbrojtjen efikase kundër diskriminimit. Komisioneri emërohet nga Parlamenti për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë (nenet 23 dhe 25). Sipas nenit 26 të ligjit, Komisioneri duhet të raportojë përpara Parlamentit me anë të një raporti vjetor mbi aktivitetet e tij.

26. Komisioneri ka kompetencën të dëgjojë ankesat për diskriminim nga persona fizikë ose organizata, të ndërmarrë hetime administrative dhe të vendosë sanksione administrative (neni 32 (1) (a), (b) dhe (ç)).



27. Gjithashtu, sipas nenit 32(1)(f), Komisioneri është kompetent për publikimin e raporteve, si edhe për dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që ka të bëjë me diskriminimin.

28. Sipas nenit 32(3), gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura përpara tij/saj, me përjashtim të rastit kur procedura përkatëse parashikohet në ligj, Komisioneri duhet të zbatojë Kodin e Procedurës Administrative, si edhe duhet të vendosë për marrjen e masave të duhura dhe afatin kohor për zbatimin e tyre (neni 33 (10)).

29. Sipas nenit 33 (11), Komisioneri mund të vendosë edhe një gjobë për palën e cila nuk i zbaton vendimet e tij.

30. Neni 34 i ligjit parashikon se kushdo që është diskriminuar ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblim përpara gjykatës kompetente në mënyrë të pavarur, ose të paraqesë një ankesë përpara Komisionerit.

D. Ligji nr. 124/2020, i datës 15 tetor 2020, i cili ndryshon ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, 2010

31. Neni 3 (16) i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar, e përcakton termin “veçim” si atë formë diskriminimi, e cila ndodh në rastet kur një person ose grup personash ndahen nga të tjerët pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dhe kjo ndarje bëhet për të paktën një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit.

32. Neni 33 (18) i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar, parashikon se vendimi i Komisionerit mund të ankimohet në gjykatën kompetente, sipas rregullave të zbatueshme për mosmarrëveshjet administrative.

E. Kodi i Procedurës Administrative

33. Neni 18 i Kodit të Procedurës Administrative i vitit 1999 (ligji nr. 8485, i datës 12 maj 1999, i ndryshuar), i cili ishte në fuqi deri më 28 maj 2016, sanksiononte parimin e kontrollit gjyqësor ndaj vendimeve administrative.

34. Neni 130 dhe 131 parashikonin se aktet administrative ishin të zbatueshëm pasi hynin në fuqi, me përjashtim të rastit kur paraqitej një ankesë me efekt pezullues.

F. Materiale të tjera

35. Në raportin vjetor për vitin 2015 përpara Parlamentit, Komisioneri pohoi se ajo kishte qenë në rolin e të akuzuarës në katërmbëdhjetë procese gjyqësore, ku palët kishin kundërshtuar vendimet e

saj në gjykatë, dhe këto të fundit ishin akte administrative.

36. Me anë të vendimit nr. 1072, të datës 23 dhjetor 2015, Këshilli i Ministrave miratoi “Planin Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016–2020”. Një nga objektivat strategjike të planit ishte rritja e aksesit për romët dhe egjiptianët në arsim pa u diskriminuar apo veçuar.

37. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 682, i datës 29 shtator 2017, i ndryshuar, parashikon, midis të tjerash, procedurat sipas së cilave fondet publike do të përdoren për transportin e nxënësve në shkollat e tyre respektive, nëse ata banonin në një distancë të caktuar prej tyre.

II. MATERIALET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

38. Në raportin e datës 15 shkurt 2006, mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut të Romëve, Sintit dhe të Shtegtarëve në Evropë (CommDH(2006)1), Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut vërejti se arsimimi i veçuar i mohonte fëmijëve romë dhe atyre jo romë mundësinë për t’u njohur me njëri-tjetrin, dhe për të mësuar se si të jetojnë si qytetarë të barabartë. Në vijim, Komisioneri theksonte se veçimi i përjashtonte fëmijët romë nga shoqëria e gjerë që në fillim të jetës së tyre, duke rritur rrezikun që ata të përfshiheshin në rrethin vicioz të margjilizimit.

39. Në rekomandimin CM/Rec(2009)4 mbi arsimimin e romëve dhe të shtegtarëve në Evropë (miratuar më 17 qershor 2009, në takimin e 1061-të të zëvendësministrave), pjesët përkatëse të të cilit parashikohen në çështjen *Oršuš dhe të Tjerët kundër Kroacisë* ([DHM]), nr. 15766/03, §§79–80 (GJEDNJ 2010), Komisioni i Ministrave rekomandoi se atje ku kishte një veçim *de facto* të fëmijëve romë dhe atyre shtegtarë, autoritetet do të duhet të zbatonin masa kundër veçimit.

40. Në rezolutën 1927(2013) të datës 23 prill 2013 për ndalimin e diskriminimit ndaj fëmijëve romë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i urdhëroi shtetet anëtare të ndalonin veçimin në shkollë dhe të promovonin përfshirjen, midis të tjerash, duke i kërkuar bashkive të përgatisnin plane kundër veçimit (§7.3.3).

41. Më 12 shtator 2017, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut publikoi



dokumentin¹ për luftën kundër veçimit në shkollë në Evropë me anë të arsimit përfshirës. Dokumenti parashikonte një sërë rekomandimesh për adresimin e veçimit në shkollë dhe realizimin e arsimit përfshirës, duke përfshirë, midis të tjerash, miratimin e strategjive kundër veçimit, rregullimin dhe monitorimin e pranimeve në shkolla, dhe përcaktimin e rajoneve të shkollave me balancë sociale.

42. Ekstrakti i mëposhtëm i Raportit (CommDH(2018)15), i datës 13 shtator 2018, nga Komisioneria për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, pas vizitës së saj në Shqipëri nga datat 21 deri më 25 maj 2018, përcakton:

“Teksa vërehet me kënaqësi se parimi për arsimim gjithëpërfshirës dhe ndalimin e diskriminimit në arsim janë përfshirë në legjislacionin shqiptar, Komisionerja është e shqetësuar për mungesën e përfshirjes së disa fëmijëve shqiptarë, veçanërisht fëmijët romë [...] në arsimin e përgjithshëm.”.

43. Raporti për Shqipërinë i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) (cikli i gjashtë monitorues), i miratuar më 7 prill 2020 dhe i publikuar më 2 qershor 2020, përmban paragrafët e mëposhtëm:

“46. Në raportin e tyre [...], autoritetet deklarojnë se ndarja e fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla nuk ekziston. 59 Sidoqoftë, në vitet e fundit ndarja është raportuar në disa shkolla, përkatësisht në Korçë, Moravë dhe Elbasan. 60 OJQ-të romë përmendën, gjithashtu, një rast të supozuar në Shkodër, në lidhje me këtë. ECRI vizitoi Korçën dhe pati takime me administratën e qytetit dhe përfaqësuesit e komunitetit rom. ECRI e kupton që situata në lidhje me ndarjen në shkolla nuk është krijuar me qëllim, por si rezultat i një përqendrimi tradicionalisht shumë të lartë të romëve dhe egjiptianëve në lagje të veçanta të qytetit (lagjet 6, 8 dhe 17). Në këtë zonë, të tri shkollat ekzistuese kanë një shumicë të nxënësve romë dhe egjiptianë me 530 nga 700 (sipas vetëdeklarimit, pasi asnjë përkatësi etnike nuk regjistrohet në regjistrin civil). Mesatarja e përgjithshme sipas shkollës është 70%: “Naim Frashëri” (95%), “Asdreni” (51%), “Ismail Qemali” (67%). ECRI vuri në dukje një qasje

konstruktive dhe pragmatike nga kryetari i Bashkisë dhe ekipi i tij për ta zgjidhur këtë çështje. Në përgjigje të ankesave për kushtet nënstandarde, €250.000 janë shpenzuar për rinovimin dhe riparimin e shkollës “Naim Frashëri”, e cila si rezultat tani konsiderohet të jetë ndër më të mirat në qytet, për sa i përket infrastrukturës materiale. Për më tepër, për sa i përket përbërjes etnike të nxënësve, administrata bashkiake po konsideron bashkimin e dy prej tre shkollave, në mënyrë që asnjë të mos ketë një raport më të lartë se 75% të fëmijëve romë ose egjiptianë. Me sa duket, një përpjekje e ngjashme për të përzier nxënësit po konsiderohet në Shkodër, për shembull, duke siguruar transport në rrethe të ndryshme shkollore.

47. ECRI rekomandon që autoritetet ta monitorojnë nga afër situatën, në lidhje me ndarjen strukturore në të vërtetë të nxënësve romë dhe egjiptianë në shkolla dhe të ndihmojnë, nëse është e nevojshme, autoritetet vendore në gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për të adresuar këtë problem.”.

44. Në Rekomandimin e Politikave të Përgjithshme nr. 13 për luftën kundër anticiganizmit dhe diskriminimit kundër romëve, miratuar më 24 qershor 2011, dhe ndryshuar më 1 dhjetor 2020, ECRI rekomandonte që qeveritë e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të merrnin masa urgjente, duke përfshirë edhe masat ligjore dhe ato politike, për t'i dhënë fund veçimit në shkollë, të cilit u nënshtrohen fëmijët romë, si edhe për t'i integruar ata në shkolla që ndiqen nga nxënës të popullatës dominuese (§4(d)).

III. RAPORTET MBI PROGRESIN TË KOMISIONIT EVROPIAN

45. Komisioni Evropian publikon raporte progresi të përvitshme për vendet të cilat dëshirojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian. Raportet analizojnë, midis të tjerash, kapacitetin e këtyre vendeve për të zbatuar standardet evropiane.

46. Në raportin e vitit 2014 për Shqipërinë (SWD(2014) 304), Komisioni Evropian konstatoi se “fëmijët romë dhe egjiptianë nuk janë integruar plotësisht në sistemin arsimor, gjë e cila me raste çon në veçim dhe përjashtim” (faqja 62).

47. Në raportin e vitit 2016 (SWD(2016) 364) konstatohej se: “veçimi në shkolla përbën një shqetësim serioz” (faqja 68). Një konstatim i ngjashëm paraqitet edhe në raportin e vitit 2018 (SWD(2018) 151) (faqja 32), ku Komisioni

¹<http://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices>



Evropian shtonte se Shqipëria duhej të “trajtonte veçimin në fushën e arsimit për grupet vulnerabël, veçanërisht për romët dhe egjiptianët” (faqja 25), por edhe në raportin e vitit 2019 (SWD(2019) 215), (faqja 32), në raportin e vitit 2020 (SWD(2020) 354) (faqja 38), dhe në raportin e vitit 2021 (SWD(2021) 289) (faqja 36).

IV. MATERIALE TË TJERA NDËR-KOMBËTARE

48. Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial u miratua në Nju-Jork, më 21 dhjetor 1965, dhe hyri në fuqi për Shqipërinë më 11 maj 1994. Nenet 2 dhe 3 parashikojnë, si më poshtë:

“Neni 2

1. Shtetet Palë dënojnë diskriminimin racial dhe marrin përsipër të ndjekin me të gjithat mjetet e duhura dhe pa vonesë një politikë për eliminimin e diskriminimit racial në të gjitha format e tij dhe promovimin e mirëkuptimit midis të gjitha racave, dhe në këtë pikë:

a) Secili Shtet Palë merr përsipër të mos përfshihet në asnjë akt ose praktikë të diskriminimit racial kundër personave, grupeve ose personave ose institucioneve, si edhe të garantojë se të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, duhet të veprojnë në përputhje me këtë detyrim;

b) Secili Shtet Palë merr përsipër të mos sponsorizojë, mbrojë ose mbështesë diskriminimin racial me anë të personave ose organizatave;

c) Secili Shtet Palë duhet të marrë masa efikase për të shqyrtuar politikat qeveritare, kombëtare dhe lokale, si edhe të ndryshojë, shfuqizojë ose anulojë çdo ligj apo rregullore, të cilat kanë ndikim në krijimin ose përjetësimin e diskriminimit racial kudo që ai të ekzistojë;

d) Secili Shtet Palë duhet të ndalojë dhe t'i japë fund, me anë të çdo mjeti të përshtatshëm, duke përfshirë legjislacionin sipas rrethanave, diskriminimit racial nga çdo person, grup apo organizatë;

e) Secili Shtet Palë merr përsipër të inkurajojë, ku është e mundur, organizatat dhe lëvizjet integruese shumëacorë, si edhe çdo mjet tjetër për eliminimin e barrierave midis racave, dhe të

çinkurajojnë çdo gjë që synon t'i hapë rrugën ndarjes raciale.

2. Kur e kërkojnë rrethanat, Shtetet Palë duhet të marrin masa konkretet, në fushën sociale, ekonomike, kulturore dhe në fusha të tjera, për të garantuar zhvillimin dhe mbrojtjen e duhur ndaj grupeve të caktuara raciale, ose ndaj individëve që janë pjesë e këtyre grupeve, me synim që t'u garantojnë atyre gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Këto masa nuk duhet të shkaktojnë në asnjë rast krijimin e të drejtave të pabarabarta ose të ndryshme për grupe të ndryshme raciale, pasi të jenë përmbushur objektivat për të cilat ato janë ndërmarrë.”.

Neni 3

“Shtetet Palë dënojnë veçimin racial dhe aparteidin dhe marrin përsipër parandalimin, ndalimin dhe shuarjen e të gjitha praktikave të kësaj natyre në territoret nën juridiksionin e tyre.”.

LIGJI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

49. Duke marrë në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata mendon se është e përshtatshme që kërkesat të shqyrtohen së bashku në një vendim të vetëm, sipas rregullit 42§1 të Rregullores së Gjykatës.

II. ÇËSHTJET PARAPRAKE

50. Gjykata vëren, në lidhje me kërkesën e parë, nr. 73548/17, se kërkesit nr. 14 deri në 18 e informuan Gjykatën, se ata dëshironin të tërhiqeshin nga kërkesa. Në vijim, kërkesit nr. 16, 17 dhe 18 paraqitën kërkesën e dytë nr. 45521/19.

51. Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë nenin 37§1(a) të Konventës, Gjykata arrin në përfundimin se nuk është e justifikueshme që të vijohet me shqyrtimin e kërkesës nr. 73548/17, për sa ka të bëjë me kërkesit nr. 14 deri në 18. Gjithashtu, në përputhje me nenin 37§1 *in fine*, Gjykata nuk konstaton asnjë rrethanë të posaçme, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të cilat parashikojnë shqyrtimin e vazhduar të kësaj pjesë të kërkesës.

52. Për sa më sipër, është me vend që të përjashtohet pjesa e kërkesës nr. 73548/17, për sa ka të bëjë me kërkesit nr. 14 deri në 18, pa paragjykim ndaj kërkesës së dytë nr. 45521/19, i cili



u paraqit në Gjykatë nga kërkesit nr. 16, 17 dhe 18.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 12 TË KONVENTËS

53. Kërkesit u ankuan në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 12 të Konventës, të cilët ishin diskriminuar kundrejt së drejtës së tyre për një arsimim përfshirës si rezultat i moszbatimit nga ana e autoriteteve të masave kundër veçimit për të adresuar mbipërfaqësimin e nxënësve romë/egjiptianë në shkollën “Naim Frashëri”.

54. Neni 1 i protokollit nr. 12 i Konventës parashikon, si më poshtë:

“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar në ligj do të garantohet pa diskriminim për asnjë nga arsyet, të tilla si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionimi politik ose ndonjë opinion tjetër, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me një minoritet kombëtar, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”.

55. Protokollit nr. 12 i Konventës u ratifikua nga Shqipëria më 26 nëntor 2004 dhe hyri në fuqi për këtë vend më 1 prill 2005.

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

56. Qeveria parashitroi se rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit, si edhe vendimi i këtij të fundit, më 22 shtator 2015, ishin të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se kërkesit kishin shteruar mjetet e brendshme, të cilat do të ishin shteruar vetëm duke paraqitur një pretendim për diskriminim në gjykatat e brendshme, sipas nenit 34 të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi (shih paragrafin 30 më sipër). Gjithashtu, Qeveria paraqiti një sërë vendimesh të brendshme, të cilat i kishin njohur pretendimet për diskriminim dhe i kishin dëmshtëpërblyer ankuesit.

57. Kërkesit e kundërshtuan atë këndvështrim dhe parashtruan se vendimet e brendshme të referuara nga Qeveria ishin lëshuar në çështjet ku kishte pasur një mosmarrëveshje për faktin nëse ankuesi kishte vuajtur diskriminim. Ata argumentuan se Komisioneri kundër Diskriminimit ishte autoriteti kompetent i brendshëm për të dëgjuar ankesat për diskriminim dhe përsëritën se as Ministria dhe as ndonjë palë tjetër nuk e kishte kundërshtuar vendimin e Komisionerit se nxënësit

e shkollës ishin subjekt i diskriminimit. Për sa i përket mungesës së një mosmarrëveshjeje mbi këtë pikë, ata prisnin që autoritetet të zbatonin vendimin e datës 22 shtator 2015 të Komisionerit kundër Diskriminimit, dhe argumentuan se do të ishte e pavlerë që të niseshin procedura të tjera gjyqësore për marrjen e një konstatimi tjetër, në lidhje me faktin se diskriminimi i nxënësve në shkollë duhej të ndalohej. Gjithashtu, kërkesit parashtruan se qëllimi i tyre kryesor ishte t'i jepej fund veçimit të shkollës në vend që të shkaktoheshin dëme.

58. Së fundmi, kërkesit pretenduan se çështja gjyqësore me interes publik e ndërmarrë nga QEDR-ja përpara Komisionerit kundër Diskriminimit korrespondonte me kërkesën ata kishin sjellë përpara Gjykatës.

2. Vlerësimi i Gjykatës

59. Gjykata thekson se arsyeja pas rregullit të shterimit është ofrimi i mundësisë për Shtetet Kontraktuese, që të parandalojnë ose të rregullojnë shkeljet e pretenduara kundër tyre përpara se këto pretendime të paraqiten në institucionet e Konventës. Ajo mbështetet në pretendimin, reflektuar në nenin 13, se urdhri i brendshëm ligjor do të garantojë një mjet efikas për shkeljen e të drejtave të Konventës. Ky është një aspekt i rëndësishëm i natyrës mbështetëse të makinerisë së Konventës (shih, për shembull, *Selmouni kundër Francës* [DHM], nr. 25803/94, §74, GJEDNJ 1999-V). Në të vërtetë, Gjykata shpesh është shprehur se në përputhje me parimin e ndihmës, është me vend që gjykatat vendëse fillimisht duhet të kenë mundësinë për të përcaktuar pyetjet e përputhshmërisë së ligjit të brendshëm me Konventën dhe, nëse përpara saj paraqitet një kërkesë, Gjykata duhet të ketë këndvështrimet e gjykatave të brendshme, duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me aspektet drejtuese e vendeve të tyre (shih *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 13378/05, §42, GJEDNJ 2008).

60. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që rregulli të zbatohet me fleksibilitet dhe pa formalizma të tepërta, duke marrë në konsideratë kontekstin e të drejtave të njeriut (shih *Ringeisen kundër Austrisë*, 16 korrik 1971, §89, Seritë A nr. 13). Rregulli për shterimin nuk është absolut dhe nuk mund të zbatohet automatikisht; teksa monitorohet përputhshmëria me këtë rregull, është e rëndësishme që të merren në konsideratë rrethanat



e çështjes konkrete (shih *Kozacioğlu kundër Turqisë* [DHM], nr. 2334/03, §40, 19 shkurt 2009).

61. Duke u kthyer në çështjen në fjalë, Qeveria nuk e trajtoi me detaje argumentimin e saj sipas së cilit vetëm procedurat gjyqësore mund të justifikojnë kërkesën për shterimin e mjeteve të brendshme. Megjithatë, duket se argumenti i Qeverisë mbështetej në pretendimin se Komisioneri dhe vendimet e tij ishin të një natyre administrative – më shumë se sa gjyqësore.

62. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren, se sipas ligjit shqiptar, Komisioneri kundër Diskriminimit është një autoritet i pavarur me fuqinë për të lëshuar vendime detyruese për subjektet publike dhe private, si edhe për të urdhëruar që këto subjekte të zbatojnë masa kundër diskriminimit (shih paragrafin 28 më sipër). Vendimet e Komisionerit mund të kundërshtohen përpara gjykatave (shih paragrafët 32 dhe 35 më sipër). Në mungesë të një ankese nga Ministria, vendimi i Komisionerit i datës 22 shtator 2015 u bë i formës së prerë dhe i zbatueshëm (shih paragrafin 34 më sipër, dhe *mutatis mutandis*, *Ramadhi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 38222/02, §49, 13 nëntor 2007, sipas së cilit Gjykata vendosi se pavarësisht nëse vendimi përfundimtar që do të zbatohet merr formën e një vendimi gjyqësor nga një autoritet administrativ, ligji i brendshëm dhe Konventa parashikojnë se ky vendim duhet të zbatohet).

63. Si përgjigje ndaj argumentit të Qeverisë se kërkuessit mund të kishin kërkuar dëmshpërblim te gjykatat e brendshme, Gjykata thekson se mjetet e brendshme duhet të jenë “efektive” ose në parandalimin e shkeljes së pretenduar ose në aspektin e vijimësisë së saj, ose në ofrimin e korrigjimit të duhur të çdo shkeljeje që ka ndodhur (shih *A.H. dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 6033/13 dhe 15 të tjerë, §347, 17 janar 2017). Në çështjen në fjalë, thelbi i ankesave të kërkuessve kishte të bënte me dështimin e autoriteteve për t’i dhënë fund situatës që kishte vazhduar prej kohësh, më konkretisht veçimit/segregimit të shkollës së tyre. Sipas kësaj situatë, vetëm një mjet që ofron mundësinë për kompensim financiar, pa ndaluar vijueshmërinë e shkeljes së pretenduar, nuk mund të konsiderohet si efektiv (shih, *mutatis mutandis*, *Patranin kundër Rusisë*, nr. 12983/14, §86, 23 korrik 2015). Në lidhje me këtë, Qeveria nuk shpjegoi se përse ka qenë e nevojshme një procedurë gjyqësore për diskriminimin, kur autoritetet nuk e diskutuan

diskriminimin e kërkuessve. Po kështu, qeveria nuk shpjegoi se përse masat kundër veçimit, të cilat u konsideruan të nevojshme nga të gjitha palët, do të ishin zbatuar me më shumë efikasitet, nëse do të urdhëroheshin me anë të një vendimi gjykate krahasuar me një autoritet të pavarur administrativ, i tillë si Komisioneri (shih, *mutatis mutandis*, *Lavdia dhe të Tjerët kundër Greqisë*, nr. 7973/10, §§47–48, 30 maj 2013).

64. Në vijim, Gjykata vëren se Qeveria nuk kundërshtoi faktin se ishte QEDR – dhe jo kërkuessit – që u ankua për Komisionerin kundër Diskriminimit për situatën në shkollë. Sipas vendimit të Komisionerit për të njohur qëndrimin e QEDR-së përpara atij autoriteti, Gjykata nuk ka arsye të dyshojë se ligji i brendshëm parashikonte të drejtën e QEDR-së për të nisur procedurat në fjalë në emër të nxënësve romë dhe egjiptianë që frekuentonin shkollën “Naim Frashëri” (shih, *mutatis mutandis*, *Kósa kundër Hungarisë* (vendim), nr. 53461/15, §§56–57, 21 nëntor 2017, dhe *J.M.B. dhe të Tjerët kundër Francës*, nr. 9671/15 dhe 31 të tjerë, §214, 30 janar 2020). Gjithashtu, përpara Gjykatës nuk u kundërshtua as fakti se lënda e ankesës së QEDR-së dhe lëshimi i vendimit të Komisionerit, i datës 22 shtator 2015, korrespondonte me këtë situatë konkrete dhe ankesat përkatëse të kërkuessve përpara Gjykatës.

65. Në këtë mënyrë, kërkuessve nuk iu kërkuar të paraqisnin një pretendim për diskriminim, i cili në thelb kishte të njëjtin objektiv si masa e QEDR-së përpara Komisionerit (shih *Kozacioğlu*, cituar më sipër, §40), përpara gjykatave të brendshme. Kështu, kundërshtimi i Qeverisë për mosshërim rrëzohet.

66. Gjykata vëren se kërkesat nuk janë as të pabazuara në fakte dhe as të papranueshme, sipas arsyeve të listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimi i palëve

67. Kërkuessit parashtruan se veçimi i tyre në shkollën “Naim Frashëri” sillte diskriminim ndaj etnisë së tyre, gjë e cila ndalohej sipas nenit 1 të protokollit nr. 12 të Konventës dhe se autoritetet nuk kishin zbatuar masat kundër veçimit që ata vetë i kishin propozuar, si për shembull bashkimin e shkollave të ndryshme për të pasur klasa më përfshirëse.



68. Qeveria parashtroi se veçimi për të cilin u ngrit ankimi ishte rezultat i ndryshimeve demografike në zonat rreth shkollës, zonë në të cilën ishin larguar shumë banorë që nuk i përkisnin komunitet rom dhe egjiptian, dhe ku ishin vendosur shumë banorë të komunitetit rom dhe egjiptian.

69. Në lidhje me skemën e ndihmës ushqimore, Qeveria deklaroi se një mbështetje e tillë ishte kërkuar nga shumë përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e kërkuarve. Në vijim, Qeveria theksoi se autoritetet nuk i kishin parandaluar kërkuarët që të mund të frekuentonin një shkollë tjetër, ose nxënësit e tjerë që të mund të ndiqnin shkollën “Naim Frashëri”. Për këtë arsye, ata nuk kishin kontribuar në ndonjë mënyrë për ta lehtësuar situatën për të cilën është bërë ankesa.

70. Në vijim, Qeveria parashtroi se ajo kishte marrë një sërë masash për të zbatuar vendimin e Komisionerit të datës 22 shtator 2015, duke përfshirë miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016–2020 (shih paragrafin 36 me sipër), shtirjen e skemës së ndihmës ushqimore për të gjithë nxënësit e shkollës, si edhe rikonstruksionin e shkollës, i cili përfundoi në kohë për vitin akademik 2019/20.

71. Në mungesë të ndonjë qëllimi apo veprimi diskriminues nga autoritetet dhe masat e miratuara për adresimin e situatës, Qeveria arrinte në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 1, të protokollit nr. 12, të Konventës.

2. *Parashtrimet e palëve të treta në lidhje me kërkesën nr. 73548/17*

72. Ndërhyrësi si palë e tretë – T’Reja Center – fillimisht bëri parashtrime për parimet e përgjithshme, sipas së cilave do të shqyrtoheshin kërkesat, dhe ofroi një sërë vërejtjesh për situatën e fëmijëve romë dhe egjiptianë në Shqipëri.

73. Veçanërisht, ndërhyrësi parashtroi se veçimi i shkollës është një nga format më të ashpra të diskriminimit. Sipas tij, veçimi i nxënësve romë/egjiptianë dëmtonte aftësinë e tyre për të mësuar në një mjedis të larmishëm dhe për të fituar aftësitë esenciale të jetës me anë të kontaktit me nxënës të tjerë.

74. Gjithashtu, T’Reja Center parashtroi statistika të cilat, sipas tyre, tregonin se veçimi i

nxënësve romë/egjiptianë ekzistonte në një sërë shkollash në Shqipëri.

3. *Vlerësimi i Gjykatës*

a) **Parimet përkatëse**

75. Pavarësisht diferencës në qëllimin midis nenit 14 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 12, kuptimi i konceptit “diskriminim” në nenin 1, të protokollit nr. 12, ishte hartuar me qëllimin për të qenë identik me atë të nenit 14 (shih paragrafët 18 dhe 19 të Raportit Shpjegues për Protokollin nr. 12). Duke përdorur të njëjtin term sipas nenit 1 të protokollit nr. 12, Gjykata nuk gjen arsye të shkëputet nga interpretimi i parashikuar për termin “diskriminim” (shih *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* [DHM], nr. 27996/06 dhe 34836/06, §55, GJEDNJ 2009, dhe *Napotnik kundër Rumanisë*, nr. 33139/13, §69, 20 tetor 2020).

76. Në vijim mund të interpretohet se, në parim, të njëjtat standarde të arritura nga Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parashikuar në nenin 14, zbatohen për çështjet e paraqitura në mbështetje të nenit 1, të protokollit nr. 12 (shih, për shembull, *ibid.*, §70).

77. Në këtë linjë, Gjykata ka parashikuar se diskriminimi nënkupton trajtimin në mënyrë të ndryshme, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme. Megjithatë, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar të trajtojë grupe të ndryshme në mënyrë të ndryshme për të korrigjuar “pabarazitë faktike” midis tyre; në të vërtetë në rrethana të caktuara, dështimi për të korrigjuar barazinë me anë të një trajtimi ndryshe në vetvete mund të shkaktojë shkelje të nenit 14 (shih *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, §101, 29 janar 2013).

78. Gjithashtu, Gjykata është e mendimit se bashkekzistenca e anëtarëve të shoqërisë pa veçim racial është një vlerë themelore e shoqërive demokratike (shih *Vona kundër Hungarisë*, nr. 35943/10, §57, GJEDNJ 2013).

79. Në lidhje me aspektin e veçimit të shkollës, Gjykata ka miratuar një sërë vendimesh, të cilat kanë të bëjnë me kontekste të ndryshme. Çështja e *D.H. dhe të Tjerët kundër Republikës së Çekisë* ([DHM]), nr. 57325/00, GJEDNJ 2007-IV) kishte të bënte me një situatë ku praktika mbarëkombëtare e vendosjes së numrit jopërpjestimor të fëmijëve romë në shkollat për nxënësit me vështirësi në të mësuar shkaktonte diskriminim sipas origjinës etnike të kërkuarve.



80. Në çështjen *Oršuš dhe të Tjerët kundër Kroacisë* ([DHM] nr. 15766/03, GJEDNJ 2010, kërkuesit ishin shtetas kroatë me origjinë etnike rome, të cilët herë pas here ishin vendosur në klasa të veçanta vetëm me nxënës romë gjatë arsimimit të tyre, me arsyen se ata nuk zotëronin mjaftueshëm gjuhën korate. Gjykata konstatoi një shkelje të ndalimit të diskriminimit për faktin, midis të tjerash, se autoritetet nuk kishin marrë hapat e nevojshëm për të siguruar progresin e shpejtë të kërkuesve në mësimin e gjuhës dhe integrimin e tyre në klasa të përziera.

b) Zbatimi i parimeve në çështjen konkrete

81. Në fillim, Gjykata konstaton se e drejta për arsimim përfshirës, për të cilin kërkuesit pretendonin se ishin trajtuar ndryshe, parashikohej në ligjin e brendshëm (shih paragrafët 18 dhe 19 më sipër).

82. Qeveria nuk kundërshtoi faktin se situata e kërkuesve përbënte veçim dhe se ishin marrë masat kundër veçimit. Po ashtu, këto pika nuk ishin kundërshtuar as nga Ministria në procedurat e saj të brendshme (shih paragrafët 5, 6 dhe 62 më sipër). Argumentet e vetme të Ministrisë ishin se situata kishte qenë e paqëllimshme.

83. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se shkolla “Naim Frashëri” nuk ishte krijuar ekskluzivisht për fëmijët romë/egjiptianë. Gjithashtu, kërkuesit nuk pretendonin se veçimi i tyre ishte i qëllimshëm. Megjithatë, Gjykata kishte vendosur më herët se diskriminimi që është potencialisht në kundërshtim me Konventën mund të rezultojë nga një situatë *de facto* (shih *Zarb Adami kundër Maltës*, nr. 17209/02, §76, GJEDNJ 2006-VIII) dhe nuk përbën domosdoshmërisht një qëllim diskriminues (*D.H. dhe të Tjerët kundër Republikës Çeke*, cituar më sipër, §184).

84. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, çështja është nëse Qeveria ka respektuar detyrimin pozitiv për të ndërmarrë hapa për korrigjimin e pabarazisë faktuale të kërkuesve dhe shmangien e përjetësimit të diskriminimit që shkatohej nga mbipërfaqësimi i tyre në shkollë (shih paragrafët 24 dhe 77 më sipër, dhe *mutatis mutandis*, *Horvath dhe Kiss*, cituar më sipër, §116 dhe §127), duke thyer në këtë mënyrë ciklin e tyre të marginalizimit dhe duke i lejuar të jetonin si qytetarë të barabartë që në fazat e hershme të jetës së tyre (shih paragrafin 38 më sipër). Në lidhje me këtë aspekt, Qeveria deklaroi se autoritetet ndërmorën masa të menjëhershme

për të adresuar veçimin e kërkuesit. Megjithatë, Gjykata vëren se vendimi për heqjen e kriterit të etnisë për nxënësit që përfitonin nga programi i mbështetjes ushqimore, në përpjekje për të tërhequr fëmijë të të gjitha etnive në shkollë, u miratua më 22 shkurt 2017 (shih paragrafin 10 më sipër), pothuajse një vit e gjysmë pas vendimit të Komisionerit të datës 22 shtator 2015. Qeveria nuk paraqiti ndonjë shpjegim për këtë vonesë, apo për vonesën në zbatimin e masës së dytë e realizuar me pretendimin për diversifikimin e grupeve të nxënësve në shkollë, më konkretisht, për rinovimin e godinës së shkollës, e cila përfundoi në shtator 2019, katër vite pas vendimit të Komisionerit. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, këto vonesa nuk respektonin aspektin kohor në një situatë ku fëmijët ishin të veçuar, si edhe me vendimin e Komisionerit që masat të merreshin “menjëherë” (shih paragrafin 8 më sipër).

85. Më e rëndësishmja është se Qeveria nuk parashtroi ndonjë arsye objektive për moszbatimin e dy masave që u diskutuan në shkresat e Ministrisë së datës 14 dhjetor 2015 dhe 14 prill 2017 (shih paragrafët 9 dhe 11 më sipër), më konkretisht zgjerimi i programit për ndihmën ushqimore në katër shkolla të tjera në atë zonë – gjë e cila mendohej se do të inkurajonte disa nga nxënësit romë/egjiptianë të kësaj shkolle të shkonin në shkolla të tjera – dhe bashkimin e shkollës “Naim Frashëri” me tri shkolla të tjera (shih paragrafët 9 dhe 11 më sipër). Të dyja këto masa kishin gjasa të kishin një efekt të menjëhershëm përfitues për fëmijët romë dhe egjiptianë. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata nuk mund të pranojë justifikimin e autoriteteve që bashkimi nuk u zbatua për shkak të rindërtimit të shkollës “Naim Frashëri”, pasi punimet e rindërtimit zgjatën vetëm për një periudhë të kufizuar kohe (shih paragrafin 12 më sipër). Në fund të vitit akademik 2019/20, nxënësit romë/egjiptianë vijonin të përfaqësonin 90% të nxënësve të shkollave.

86. Sipas argumentimit të Qeverisë se veçimi i raportuar ishte shkaktuar nga përqendrimi i popullatës rome/egjiptiane në lagje të caktuara pranë shkollës së veçuar, propozimi i autoriteteve për të bashkuar këtë shkollë me shkolla jo të veçuara në qytet dukej si një zgjidhje me të vërtetë me vend. Një bashkim i tillë mund të ndihmonte në krijimin e shkollave ku raporti midis fëmijëve romë/egjiptianë dhe nxënësve të tjerë do të ishte



në përpjesëtim të drejtë me raportin në qytet për shkollat fillore. Autoritetet kishin zbatuar tashmë zgjidhje të ngjashme në lidhje me shkollat e veçuara në zona të tjera në vend, ku kishin ofruar edhe transportin për nxënësit (shih paragrafët 16, 37 dhe 43 më sipër). Faktikisht, nuk i takon Gjykatës të përcaktojë masat specifike që duhet të ndërmerren për të korrigjuar situatën e veçimit në një shkollë, megjithatë, është e vështirë të kuptohen arsyet se përse kjo qasje nuk u zbatua në çështjen konkrete.

87. Gjykata vëren se ajo ka konstatuar një shkelje të ndalimit të diskriminimit në një kontekst të ngjashëm, ku Shteti nuk ka zbatuar masat kundër veçimit (shih *Lavida dhe të tjerët*, cituar më sipër, §73). Gjykata është e mendimit se edhe në çështjen në fjalë, vonesat dhe moszbatimi i masave të duhura kundër veçimit nuk mund të interpretohen se kanë pasur një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

88. Për këtë arsye, është shkelur neni 1, i protokollit nr. 12, të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENEVE 41 DHE 46 TË KONVENTËS

A. Neni 41 i Konventës

89. Neni 41 i Konventës parashikon, se:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

1. Shpërblimi

90. Kërkuesit kërkuar 4500 euro (EUR) për secilin kërkues fëmijë për dëmin jopasuror.

91. Qeveria parashtroi se kërkesa ishte e paarsyeshme dhe e paargumentuar.

92. Në mbështetje edhe të dokumenteve në zotërimin e saj dhe praktikës së saj gjyqësore (shih, veçanërisht, *Lavida dhe të tjerët*, cituar më sipër, §80), Gjykata e gjykon të arsyeshme që të akordojë 4500 euro për secilën familje të kërkuesve për dëmin jopasuror.

2. Kostot dhe shpenzimet

93. Kërkuesit nuk paraqitën ndonjë pretendim për kosto dhe shpenzime. Në këtë mënyrë, Gjykata nuk u akordon atyre ndonjë shumë nën këtë kategori.

3. Interesi për pagesën e vonuar

94. Gjykata e gjykon me vend që norma e interesit për pagesën e vonuar duhet të mbështetet

në normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, se cilit do t'i shtohen tre për qind pikë.

B. Neni 46 i Konventës

95. Neni 46 i Konventës parashikon, si më poshtë:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”.

96. Gjykata thekson se, sipas nenit 46 të Konventës, Palët Kontraktuese kanë marrë përsipër të respektojnë vendimet e Gjykatës në çështjen në të cilat ata janë palë, ndërsa zbatimi do të mbikëqyret nga Komisioni i Ministrave të Këshillit të Evropës. Në vijim, *inter alia*, theksohet se kur Gjykata konstaton një shkelje në një vendim ajo vendos një detyrim ligjor për Shtetin e paditur, pavarësisht nëse kërkuesi ka kërkuar apo jo shpërblim të drejtë, ajo duhet të për zgjedhë, nën mbikëqyrjen e Komisionit të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është me vend, individuale, të cilat duhet të miratohen në urdhrin e saj ligjor të brendshëm për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe të korrigjojë efektet sa më shumë të jetë e mundur. Nën monitorimin e Komisionit të Ministrave, Shteti i paditur ka lirinë të për zgjedhë mënyrën sipas së cilës ai do të shlyejë detyrimin e tij ligjor, në mbështetje të nenit 46, për aq kohë sa kjo mënyrë është në përputhshmëri me konkluzionet dhe frymën e vendimit të Gjykatës (shih *Aliyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 68762/14 dhe 71200/14, §221, 20 shtator 2018, me referenca të tjera). Për sa i përket shkeljes së konstatuar në çështjen konkrete, Gjykata gjykon se masat që duhet të ndërmerren duhet të garantojnë përfundimin e diskriminimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës “Naim Frashëri”, sipas vendimit të Komisionit, të datës 22 shtator 2015.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. Vendos t'i bashkojë kërkesat;

2. Vendos ta përjashtojë kërkesën nr. 73548/17 nga lista e çështjeve për sa ka të bëjë me kërkuesit 14 deri 18;

3. E deklaron pjesën tjetër të kërkesave të pranueshme;



4. Gjykon se është shkelur neni 1 i protokollit nr. 12 i Konventës për të dyja kërkesat;

5. Gjykon:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë secilës familje të kërkuësve, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, 4500 euro (katër mijë e pesëqind euro) plus çdo taksë të tarifueshme, për dëmin jopasuror, të cilat do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se që nga përfundimi i periudhës tremujore të përmendur më sipër dhe deri në shlyerjen e shumës, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumën e mësipërme në një normë të

barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonësës së pagesës plus tre për qind pikë;

6. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuësve për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 31 maj 2022, sipas Rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
SEKRETAR

Georges Ravarani
KRYETAR

SHTOJCË

Kërkesa nr. 73548/17 dorëzuar më 5 tetor 2017:

Nr.	Muaji dhe viti i lindjes së kërkuësit	Familja nr.	Shumat sipas nenit 42 (për dëm jopasuror) në euro për familje
1	Dhjetor 1977	1	4500
2	Korrik 2005		
3	Korrik 2009		
4	Nëntor 1983		
5	Shkurt 2000	2	4500
6	Mars 2003		
7	Gusht 2009		
8	Dhjetor 2005		
9	Prill 1983	3	4500
10	Tetor 2005		
11	Tetor 1979	4	4500
12	Prill 2010		
13	Janar 2004		
14	Janar 1980	5	I pazbatueshëm
15	Prill 2006		
16	Tetor 1962	6	Shuma jepet vetëm për kërkesën e dytë
17	Nëntor 2007		
18	Korrik 2004		

Kërkesa nr. 45521/19, e paraqitur më 26 gusht 2019, nga kërkuësit nr. 16, 17 dhe 18. Shuma sipas nenit 41: 4500 euro.



URDHËR

Nr. 431, datë 27.9.2022

**PËR DISA SHTESA NË URDHËRIN NR.
365, DATË 10.8.2022, “PËR IMPORTIN E
KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA,
PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË
TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA
HUNGARIA, LETONIA, UKRAINA,
RUMANIA, ITALIA, GJERMANIA,
LITUANIA, MOLDAVIA, SLLOVAKIA,
SERBIA, ESTONIA, BULLGARIA,
POLONIA DHE MAQEDONIA
E VERIUT”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 365, datë 10.8.2022, bëhen shtesat si vijon:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat:

a) Në paragrafin e parë “Shteti i Hungarisë”, shtohet togfjalëshi:

“qarku Pest, qyteti Pílisvörösvár”;

b) Në paragrafin e dytë “Shteti i Letonisë”, shtohet togfjalëshi:

“rajoni Latgales, qyteti Krāslavas, njësi administrative Šķaunes; rajoni Kurzemes, qyteti Kuldīgas, njësi administrative Ēdoles; qyteti Madonas, njësi administrative Prāulienas; rajoni Kurzemes, qyteti Tukuma, njësi administrative Slampes; rajoni Zemgales, qyteti Dobeles, njësi administrative Annenīeku; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësi administrative Gaigalavas; rajoni Latgales, qyteti Preiļu, njësi administrative Rušonas; rajoni Kurzemes, qyteti Tukuma, njësi administrative Degoles, njësi administrative Vārkavas; rajoni Kurzemes, qyteti Dienvidkurzemes, njësi administrative Sakas; rajoni Vidzemes, qyteti Cēsu, njësi administrative Raiskuma; rajoni Kurzemes, qyteti Ventspils, njësi administrative Vārves; rajoni Latgales, qyteti Ludzas, njësi administrative Nukšu; rajoni Latgales, qyteti Balvu, njësi administrative

Lazdulejas; rajoni Vidzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Ošupes; rajoni Kurzemes, qyteti Talsu, njësi administrative Lībagu; rajoni Kurzemes, qyteti Kuldīgas, njësi administrative Skrundas; rajoni Vidzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Aronas; rajoni Vidzemes, qyteti Gulbenes, njësi administrative Daukstu; rajoni Vidzemes, qyteti Alūksnes, njësi administrative Liepnas; rajoni Vidzemes, qyteti Gulbenes, njësi administrative Stāmerienas; rajoni Latgales, qyteti Balvu, njësi administrative Kubulu; rajoni Vidzemes, qyteti Madonas, njësi administrative Ošupes; rajoni Vidzemes, qyteti Smiltenes, njësi administrative Grundzāles; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësi administrative Silmalas; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësi administrative Ilzeskalna; rajoni Latgales, qyteti Preiļu, njësi administrative Rušonas; rajoni Latgales, qyteti Rēzeknes, njësi administrative Gaigalavas”;

c) Në paragrafin e pestë “Shteti i Gjermanisë”, shtohet togfjalëshi:

“rajoni Niedersachsen, qyteti Cloppenburg, njësi administrative Garrel; rajoni Niedersachse, qyteti Emsland, njësi administrative Twist; rajoni Schleswig-Holstein, qyteti Nordfriesland, njësi administrative Südtondern; rajoni Brandenburg, qyteti Spree-Neiße, njësi administrative Peitz”;

ç) Në paragrafin e nëntë “Shteti i Serbisë”, shtohet togfjalëshi:

“rajonet Južnobanatski, Niiavski, Pomoravski, Pčinjski, Jablanički dhe Podunavski”;

d) Në paragrafin e trembëdhjetë “Shteti i Maqedonisë së Veriut”, shtohet togfjalëshi:

“qyteti Kočani, qyteti Vinitsa”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



VENDIM

Nr. 4191, datë 28.9.2022

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE
DHE NDRYSHIMEVE
NË UDHËZIMIN NR. 3241,
DATË 18.12.2014, “PËR SIGURIMIN
E DEPOZITAVE NË BANKA”,
TË NDRYSHUAR**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 3, pika 2, dhe 4, nenit 11, shkronja “c”, nenit 25, shkronjat “ç” “d”, “dh” dhe “e”, nenit 26, pika 2, nenit 27, pika 1, nenit 43, pika 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “g”, nenit 53, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar; si dhe të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 24, datë 29.8.2022,

VENDOSA:

I. Në udhëzimin nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si vijon:

1. Në nenin 4, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “g” fjala “kujdestari” zëvendësohet me fjalën “banka agjente”.

b) pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “h”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“h) *Paraqitja unike e depozituesve (Single Customer View)* janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike, në sistemin informatik të bankës, nëpërmjet të dhënave të tij identifikuese, ku përcaktohen saktë depozitat e sigurueshme, si dhe shuma e kompensimit që përfiton ky depozitues.”.

2. Në nenin 14, pika 10, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “P” me përmbajtjen e mëposhtme:

“f) *miratimin për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë.*”.

3. Në nenin 17, pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. *Agjencia zotëron Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, me qëllim raportimin e informacionit për paraqitjen unike të depozituesve nga bankat anëtare të skemës, verifikimin e saktësisë të informacionit të raportuar*

dhe përdorimin e tij në funksion të sigurimit dhe kompensimit të depozitave.”.

4. Neni 19 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë dhe raportimi i të dhënave në të nga bankat funksionon në mënyrë të tillë që të sigurojë:

a) *Ngarkimin nga bankat anëtare të skemës të skedarëve me të dhënat për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe të depozituesve të përjashtuar nga skema, sa herë që kërkohet nga Agjencia, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi;*

b) *Kryerjen e kontroleve për vlerësimin e saktësisë së skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi;*

c) *Krijimin e listë – pagesës me paraqitjen unike të depozituesve, si dhe dërgimin e saj, në rast simulimi ose kompensimi, në subjektet e përcaktuara në aktet nënligjore të Agjencisë;*

d) *Vlerësimin e saktësisë të përllogaritjes të shumës së siguruar dhe të përllogaritjes të primit të sigurimit të depozitave;*

e) *Vlerësimin e saktësisë të përllogaritjes të shumës së kompensimit në rast simulimi ose ngjarjeje sigurimi;*

f) *Prodhimin e raporteve periodike dhe atyre të kërkuara rast pas rasti nga Agjencia, për qëllim të kryerjes së analizave statistikore dhe vlerësimeve të nevojshme.*”.

5. Në nenin 20, pika 1, pas fjalëve “... mbi gjendjen e depozitave” shtohen fjalët “..., të nevojshme për vlerësimin e saktësisë së llogaritjes së primit të sigurimit, si dhe saktësisë së paraqitjes unike të depozituesve, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi.”.

6. Në nenin 21, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 3 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. *Likuidatori dhe banka agjente kanë të drejtën të njihen me informacionin që përpunohet në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, në përputhje me të drejtat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.*”.

b) Pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. *Në rast ngjarjeje sigurimi, depozituesit kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi shumën e kompensimit, që ata përfitojnë, pranë Agjencisë, likuidatorit, ose bankës agjente.*”.

7. Në nenin 22, bëhen ndryshimet e mëposhtme:



a) Në pikën 1, fjalët “... sipas nenit 20 të këtij udhëzimi ...” zëvendësohen me fjalët “... sipas dispozitave të këtij udhëzimi”.

b) Pika 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Autenticiteti i të dhënave të raportuara nga bankat anëtare të skemës në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, si dhe pandryshueshmëria e tyre verifikohet nga bankat nëpërmjet kodit të gjeneruar menjëherë, pas raportimit të suksesshëm dhe të sigurt të të dhënave. Ky kod siguron se të dhënat e transmetuara kanë mbetur të pandryshuara dhe janë origjinale me dhënat e dërguara nga bankat.”

c) Në pikën 7, pas fjalëve “... për periudha dhe qëllime specifike”, shtohen fjalët “..., të përcaktuara në këtë udhëzim”.

d) Pika 8 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“8. Për qëllim të përlogaritjes të shumës së sigurimit bankat ngarkojnë, çdo muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës, skedarin përkatës të depozitave të sigurueshme dhe të pasigurueshme, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.”

e) Pika 10 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në rast procesi kompensimi ose simulimi nga Agjencia, bankës do t’i kërkohej të ngarkojë skedarë ditorë për paraqitjen unike të depozituesve, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë me të dhëna mbi:

a) Depozitat – të dhënat për çdo depozitë të sigurueshme dhe të pasigurueshme në bankë;

b) Depozituesit – të dhënat e detajuara të depozituesve të siguruar dhe të përjashtuar nga skema që i identifikojnë ata saktësisht;

c) Kreditë – kreditë e detajuara të lidhura me depozitat që janë vënë si garanci për këto kredi;

d) Pozicioni i netuar i depozituesve – depozituesit në pozicionin e netimit.”

f. Pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“10/1. Agjencia në rast simulimi, ka të drejtën të kërkojë, nga bankat anëtare të skemës, ngarkimin e skedarit për depozituesit, të përcaktuar në pikën 10, shkronja “b” të këtij neni, me të dhëna të anonimizuara, sipas udhëzimeve të saj.”

8. Në nenin 25 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“2. Banka dërgon për miratim pranë Agjencisë kërkesën për krijimin e përdoruesit të autorizuar ose mbylljen e tij,

sipas formatit të përcaktuar në aneksin 8 të këtij udhëzimi, si dhe kërkesën për akses në rrjetin privat virtual (VPN), sipas formatit të kërkesës të përcaktuar në aneksin 8/1 të këtij udhëzimi.”

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1. Përdoruesit e autorizuar të bankave zbatojnë udhëzimet e Agjencisë për aksesin në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, nëpërmjet rrjetit virtual (VPN). Në rast se përdoruesi i autorizuar nuk është aktiv për më shumë se tre muaj, Agjencia ka të drejtë të kryejë çaktivizimin e tij. Riaktivizimi i përdoruesit mund të bëhet me kërkesë me e-mail nga banka, dërguar personit të autorizuar të Agjencisë.”

9. Në nenin 27, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“1. Agjencia ruan të dhënat për përlogaritjen e primit të sigurimit për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare) nga data e raportimit të skedarëve të depozitave në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim. Agjencia ruan të dhënat për procesin e simulimit vetëm gjatë kohëzgjatjes së këtij procesi.”

b) Në pikën 2, fjalët “... në sistemin informatik informacionin dhe të dhënat e raportuara për depozitat ...” zëvendësohen me fjalët “... në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim informacionin dhe të dhënat e raportuara për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe listëpagesën e depozituesve, ...”.

c) Në pikën 3, fjalët “Pas përfundimit të afatit të lartpërmendur, ...” zëvendësohen me fjalët “Pas përfundimit të afateve të përcaktuara në këtë nen, ...”.

10. Në nenin 28, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në emërtimin e nenit, pas fjalëve “... për mbajtjen e regjistrit të tyre elektronik ...” shtohen fjalët “... për paraqitjen unike të depozituesve”.

b) Në pikën 1, pas fjalëve “... në përputhje me anekset 4, 5 të këtij udhëzimi.” shtohen fjalët “..., për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet, nga data e raportimit të këtyre të dhënave në Agjenci.”

c) Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Bankat mundësojnë gatishmërinë e prodhimit të skedarëve për krijimin e paraqitjes unike të depozituesve, në çdo kohë dhe sipas kërkesës së Agjencisë, në përputhje me aneksin 5 të këtij udhëzimi.”

d) Pika 3 shfuqizohet.

e) Në pikën 5, fjalët “..., si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme lidhur me përfshirjen e tyre në sistemin informatik



dhe zbatimin e akteve nënligjore përkatëse.”, zëvendësohen me fjalët “... si dhe lidhur me mbajtjen, përgatitjen dhe raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe auditojnë përputhshmërinë e zbatimit të kërkesave të Agjencisë, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.”.

11. Në nenin 30, pika 2 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Raportin për depozituesin me informacionin përkatës, që nxirret nga Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë, në rast ngjarjeje sigurimi, bazuar në kërkesën e tij.”.

12. Neni 33 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Agjencia kryen verifikime për kontrollin e përmbushjes së kushteve për sigurimin dhe kompensimin e depozitave nga bankat, të cilat paraqesin kërkesë për t'u anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave, bankat anëtare të skemës, si dhe bankat që janë në proces të riorganizimit juridik.

2. Për qëllim të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, llojet e verifikimeve që kryhen nga Agjencia janë:

a) verifikime të plota, në të cilat përfshihen çështjet e përcaktuara në nenin 34 pika 1 të këtij udhëzimi;

b) verifikime të pjesshme, në të cilat përfshihen çështjet e përcaktuara në nenin 34, pika 2, të këtij udhëzimi.

3. Agjencia ka të drejtë të kryejë:

a) verifikimet në vend, në ambientet e bankës;

b) verifikime në distancë, nëpërmjet raportimeve të të dhënave dhe informacionit nga bankat në Agjenci;

c) verifikime të kombinuara, duke kryer një pjesë të punës nga ambientet e Agjencisë dhe një pjesë të punës në ambientet e bankës.

4. Frekuenca e kryerjes së verifikimeve të Agjencisë është si vijon:

a) verifikime të plota në vend, të paktën një herë në vit, gjatë tre viteve të para të anëtarësimit të bankave në skemën e sigurimit të depozitave;

b) verifikime të plota në vend, të paktën një herë në dy vjet, për bankat të cilat janë më shumë se tre vjet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;

c) verifikime të pjesshme në distancë ose të kombinuara, çdo tre muaj, me objekt kontrollin e saktësisë së përlogaritjes të primit të sigurimit, të raportuar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

d) verifikime të pjesshme në distancë ose të kombinuara, të paktën një herë në vit, me objekt kontrollin e gatishmërisë së sistemit të bankave anëtare, për raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim.

5. Agjencia sipas rastit kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të saj në ekzaminimet, që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në banka.

6. Agjencia verifikon bankat nëpërmjet Grupit të Verifikimit, i cili përbëhet nga punonjës të Agjencisë, sipas çështjeve konkrete të verifikimit.

7. Gjatë procesit të verifikimit bankat kanë këto të drejta:

a) e drejta për t'u informuar me programin e verifikimit, i cili përmban objektin, qëllimin dhe kohëzgjatjen e procesit të verifikimit. Agjencia njofton bankat të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së planifikuar për kryerjen e verifikimit. Si përjashtim nga kjo rregull, në raste të veçanta, kur është i nevojshëm kryerja e verifikimit të menjëhershëm, afati i njoftimit mund të jetë më i shkurtër, por në çdo rast i shoqëruar me një shkrues nga drejtori i përgjithshëm;

b) e drejta për të komunikuar me grupin e verifikimit me qëllim informimin mbi ecurinë e procesit të verifikimit;

c) e drejta për të shprehur komentet në lidhje me gjetjet dhe përfundimet paraprake të procesit të verifikimit. Përfundimet paraprake, që do të jenë pjesë e raportit të verifikimit, i dërgohen me e-mail bankës për komente përfundimtare, të cilat duhet të paraqiten nga banka brenda 5 (pesë) ditësh pune. Nëse banka nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, raporti i verifikimit do të konsiderohet i dakordësuar;

d) e drejta për të marrë nga Agjencia një kopje të raportit përfundimtar të verifikimit.

8. Gjatë procesit të verifikimit bankat kanë këto detyrime:

a) të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për mbarëvajtjen e punës të Grupit të Verifikimit, siç janë, por pa u kufizuar: mjedise pune të dedikuara për anëtarët e grupit të verifikimit, akses në internet dhe telefon etj.;

b) të vendosin në dispozicion të Grupit të Verifikimit informacionin, të dhënat dhe dokumentet, që kanë lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave, brenda afateve dhe në formën e kërkuar prej tij;

c) të sigurojnë disponueshmërinë e personave të kontaktit dhe përgjegjës të bankës për të bashkëpunuar dhe të marrë pjesë në intervistat me Grupin e Verifikimit;

d) të sigurojnë vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit, të të dhënave dhe dokumenteve, që i paraqiten Grupit të Verifikimit të Agjencisë;

e) t'i mundësojnë Grupit të Verifikimit, nëpërmjet personave përgjegjës të bankës, akses në sistemet informatike, që përpunojnë të dhëna për depozitat dhe depozituesit, me qëllim verifikimin e tyre;

f) të zbatojnë rekomandimet, veprimet dhe/ose masat rregulluese të përcaktuara në Raportin e Verifikimit, si dhe



të raportojnë në Agjenci lidhur me ecurinë e zbatimit të tyre, në mënyrën dhe afatin e kërkuar.”.

13. Në nenin 34, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalia “Drejtimit kryesore të procesit të verifikimit janë, por pa u kufizuar:” zëvendësohet me fjalinë “Verifikimet e plota që Agjencia kryen në banka kanë si objekt verifikimin e çështjeve të mëposhtme, por pa u kufizuar.”.

b) Në pikën 1, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “b/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“b/1. Verifikimi i bankës, për:

i. saktësinë e përgatitjes dhe ngarkimit në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve;

ii. gatishmërinë e sistemit elektronik të bankës për të gjeneruar raportin e cilësisë së të dhënave, sipas formatit të përcaktuar nga Agjencia;”

c) Pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Verifikimet e pjesshme që Agjencia kryen në banka kanë si objekt verifikimin e çështjeve të mëposhtme:

a) saktësinë e përllogaritjes të primit të sigurimit të raportuar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

b) gatishmërinë e bankave për raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

c) çështje të tjera me tematikë të caktuar në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave.”.

14. Aneksi 4 i udhëzimit riemërtohet “Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të bankës për paraqitjen unike të depozituesve”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

15. Aneksi 5 i udhëzimit riemërtohet “Parametrat teknikë që duhet të plotësojë, dhe raportet që duhet të gjenerojë sistemi informatik i bankës për regjistrin elektronik të detyrimeve depozitë për paraqitjen unike të depozituesve”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

16. Aneksi 8 i udhëzimit “Kërkesë për akses në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim” zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Pas aneksit 8 të udhëzimit shtohet aneksi 8/1, “Kërkesë për akses në rrjetin privat virtual (VPN)”.

që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Në Aneksin 10, formulari 2 i udhëzimit, “Aneksi i kontratës së depozitës për informimin e publikut”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

19. Aneksi 17 i udhëzimit, “Raporti mujor i përputhshmërisë të balancave të depozitave, sipas bilancit të përgjithshëm me formatin e fluksit të depozitave të dërguar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

20. Termat “sistem”, “sistemi i Agjencisë”, “sistemi informatik”, “sistemi informativ” dhe “sistemi elektronik” zëvendësohen me termin “Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim”, përkatësisht në nenin 4, pika 1, shkronja “g”; në nenin 13, pika 6; në nenin 18; në nenin 21, pika 1, pika 2; në nenin 22, pika 1, pika 2, pika 6; në nenin 23, pika 4, pika 5, pika 6; në nenin 24; në nenin 25, pika 3; në nenin 26 – emërtimi, pika 1 dhe pika 3; në nenin 27 – emërtimi; në nenin 28, pika 4, pika 6; në nenin 29; në nenin 30 – emërtimi, pika 1; në nenin 31, pika 1 dhe në nenin 32 të udhëzimit.

II. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

III. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

GUVERNATORI
Gent Sejko

ANEKSI 4
REGJISTRI ELEKTRONIK I DETYRIMEVE
DEPOZITË TË BANKËS
PËR PARAQITJEN UNIKE TË
DEPOZITUESVE

Bankat mbajnë informacione dhe të dhëna të sakta e të detajuara për paraqitjen unike të depozituesve, si vijon:



1. Mban dhe siguron me një kod të vetëm (unik) çdo depozitues me këto të dhëna të detyrueshme (në sistemin elektronik të bankës dhe në letër):

a) të dhënat për individët: emër, mbiemër, atësi, **numër personal, të dhënat për mjetin e identifikimit, gjini, datëlindjen, adresë, numër telefoni;**

b) të dhënat për tregtarët dhe shoqëritë tregtare: **numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS), data e regjistrimit, emërtimi i subjektit, forma ligjore.**

c) të dhënat për depozitat: **kodi unik i depozitës, tipin e depozitës, numrin e titullarëve të depozitës dhe lidhjen e tyre me depozitat përkatëse; balancën e depozitës, monedha e depozitës, norma e interesit, interesin e llogaritur në ditën e vlerësimit/ndërhyrjes, kursi i këmbimit.**

2. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave kolateral ose të vendosura si garanci dhe të dhënat analitike të kredive të bankës për të cilat këto depozita janë barrësuar;

3. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin në sistemet elektronike të informacionit të të dhënave analitike për kreditë që ka çdo depozitues në bankë;

4. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave të vendosura në përfitim të të tretëve me/pa kusht dhe afat përfitimi me të dhënat analitike të kontratave përkatëse;

5. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit për depozitat dhe depozituesit e bankës, që janë të përjashtuar nga skema e sigurimit të depozitave;

6. Mban dhe siguron identifikimin dhe gjurmimin, nëse dërgesat dhe instrumentet e pagesave (p.sh., urdhër në arkë, transfertat ndërbankare, transfertat nëpërmjet internetit e të tjera transfertat elektronike) janë të bëra nëpërmjet pagesave “cash” ose duke debituar llogarinë e depozitës. Kjo gatishmëri është në funksion të administrimit e rregullimeve, që lidhen me balancat e depozitave, me dërgesat pezull dhe faturat gjendje – të pagueshme;

7. Mban dhe siguron gjurmimin nëse çeqet e kredituara nga llogaritë e depozitave janë ekzekutuar (ose imazhi i çeqeve të dëmtuar, është dërguar) për klering. Ky informacion përvakton nëse shumat e depozitave të siguruar duhet të korrigjohen për efekt të çeqeve të paekzekutuara për klering dhe çeqet e kthyera mbrapsh.

ANEKSI 5

PARAMETRAT TEKNIKË QË DUHET TË PLOTËSOJË DHE RAPORTET QË DUHET TË GJENEROJË SISTEMI INFORMATIK I BANKËS PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK TË DETYRIMEVE DEPOZITË PËR PARAQITJEN UNIKE TË DEPOZITUESVE

1. Sistemi informatik i bankës duhet të mundësojë në çdo kohë, vendosjen e parametrave të mëposhtëm:

a) shuma e mbulimit;

b) kursi zyrtar i këmbimit në ditën e vlerësimit;

c) kodin unik të identifikimit të depozituesit;

d) të gjitha kategoritë e produktit depozitë për depozituesin subjekt i skemës;

e) të gjitha kategoritë e produktit kredi për depozituesin subjekt të skemës;

f) detyrime të tjera të depozituesit ndaj të tretëve;

g) kushtet përjashtuese sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

2. Sistemi informatik i bankës duhet të mundësojë në çdo kohë gjenerimin e raporteve të mëposhtme:

a) Paraqitjen unike të çdo depozituesi (individ, tregtar, shoqëri tregtare) të bankës, lidhur me:

i. të dhënat identifikuese të tij;

ii. depozitat e tij (secilën nga depozitat dhe të marra së bashku);

iii. detyrimet në vonesë ndaj bankës (kredi, overdraft, garanci etj., çdo detyrim më vete, si dhe të marra së bashku);

iv. pozicionin neto të tij (depozita–kredi, të drejta-detyrime në vonesë);

b) listën e plotë e depozituesve të bankës që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, së bashku me shumën përkatëse të depozitave të agreguara;

c) listën e depozituesëve të bankës që nuk janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, sipas nenit 32, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;

d) listën e depozitave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të depozitave sipas nenit 32 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;

e) konvertimin në lekë të të gjitha depozitave në monedhë të huaj me kursin zyrtar të këmbimit i



përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit/ndërhyrjes, sipas kërkesës së Agjencisë;

f) listën e depozituesve që kanë një detyrim kundrejt bankës, me shumën përkatëse të kredisë që ata kanë;

g) listën e depozituesve që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm, e

shoqëruar me shumën përkatëse të depozitave të tyre krahasuar me nivelin e mbulimit;

h) listën e depozituesve me shumën e kësteve të papaguara në afat që burojnë nga marrëdhënia kreditore e depozituesit me subjektin;

i) evidentimi i depozitave kolateral dhe i depozitave të vendosura në përfitim të tretëve;

j) raporte të ndryshme statistikore në varësi të situatave të ndryshme që do të paraqiten.

ANEKSI 8

KËRKESE PËR AKSES NË SISTEMIN INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM

FORMULARI I KËRKESES PËR PËRDORUES			
Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar një përdorues të ri (të autorizuar) ose për të mbyllur një përdorues ekzistues (të autorizuar).			
Për:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave Sektori i Teknologjisë së Informacionit		
Nga Banka: _____		Data e kërkesës: ____-____-____ <i>(dd.mm.vvvv)</i>	
Nr .	Emër Mbiemër i përdoruesit	Adresa e <i>email</i> -it	Veprimi
			☐ Krijim përdoruesi
			☐ Mbyllje përdoruesi
			☐ Krijim përdoruesi
			☐ Mbyllje përdoruesi
Për Bankën		Për Agjencinë	
Autorizuesi i kërkesës		Autorizuesi i kërkesës	
(_____)		(_____)	



ANEKSI 8/1
KËRKESË PËR AKSES NË RRJETIN PRIVAT VIRTUAL (VPN)

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES			
Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar përdorues të ri ose për të mbyllur përdorues ekzistues.			
Për:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave Sektori i Teknologjisë së Informacionit		
Nga Banka: _____		Data e kërkesës: _____._____._____ (dd.mm.vvvv)	
Nr	Përdoruesi	Adresa e email-it	Veprimi
			☐ Krijim përdoruesi
			☐ Mbyllje përdoruesi
Për Bankën Autorizuesi i kërkesës (_____)		Për Agjencinë Autorizuesi i kërkesës (_____)	



FORMULARI 2
ANEKS I KONTRATËS SË DEPOZITËS
PËR INFORMIMIN E PUBLIKUT
FORMULARI

Informacion bazë për sigurimin e depozitave në (emri i institucionit, bankës)	
Depozitat në bankën (emri i Bankës) janë të siguruara nga:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Niveli maksimal i mbulimit:	LEKË 2.500 000 për çdo depozitues në çdo bankë ²
Nëse Ju keni më shumë se një depozitë në bankë:	Të gjithë depozitat tuaja në bankë do të mbliidhen me qëllim përlllogaritjen e nivelit maksimal të mbulimit.
Nëse Ju keni një depozitë të përbashkët me një ose më shumë persona të tjerë:	Niveli maksimal i mbulimit prej 2.500.000 lekësh llogaritet për secilin depozitues më vete.
Periudha e kompensimit në rast të likuidimit të detyruar të bankës:	Jo më vonë se 3 muaj nga data e fillimit të procesit të kompensimit.
Monedha në të cilën do të kompensohet depozituesi:	Lek ³
Për më shumë informacion kontaktoni:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave Rruga e Elbasanit, nr. 317, Tiranë info@asd.gov.al, +35542362989, +35542347298
Informacione të tjera:	www.asd.gov.al
Nënshkrimi i depozituesit:	
Informacione shtesë	

1. Niveli maksimal i kompensimit.

Në rastin kur me vendim të Bankës së Shqipërisë, banka vendoset në likuidim të detyruar, depozitat tuaja do të kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Shuma e kompensimit është deri në nivelin maksimal 2.500.000 lekë.

Kjo do të thotë që të gjitha depozitat që ju keni në bankën tonë, do të mbliidhen për të përcaktuar nivelin maksimal të mbulimit. Për shembull, nëse ju jeni mbajtës i një llogarie kursimi me 2.300.000 lekë dhe një llogarie rrjedhëse me 1.000.000 lekë, do të kompensoheni në shumën 2.500.000 lekë.

- Në rastin e llogarive të përbashkëta, kufiri prej 2.500.000 lekësh llogaritet për çdo depozitues.

- Në rastin e depozitave me person të autorizuar, sigurohet dhe kompensohet vetëm titullari i depozitës.

- Nëse ju jeni një individ, që keni llogari personale dhe llogari të biznesit tuaj në bankë, ju do të kompensoheni deri në 2.500.000 lekë, si individ, dhe deri në 2.500.000 lekë, si biznes.

- Në rast se ju keni edhe kredi në bankë, nga shuma e llogaritur për kompensim do t'ju zbritet shuma e detyrimeve me vonesë që rezultojnë të pashlyera në ditën e vendosjes së bankës në likuidim të detyruar, nëse ka.

2. Në rastet e transformimit të bankës, nëpërmjet bashkimit ose ndarjes me një bankë tjetër, depozitat tuaja në secilën bankë pjesë e këtij transformimi, mbeten të siguruara më vete për 3 (tre) muaj nga data e përfundimit të procesit të transformimit.

3. Në përgjithësi, të gjithë depozituesit individë dhe bizneset sigurohen dhe kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Informacioni i përditësuar për përjashtimet për disa depozitues dhe depozita është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Gjithashtu, me kërkesën tuaj, banka do t'ju informojë mbi depozitat e përjashtuara. Nëse depozita është e siguruar, banka e konfirmon këtë edhe në pasqyrën e depozitës suaj.

² Agjencia siguron dhe kompenzon depozitat në bankën ... (emri i bankës), por në çdo rast jo më shumë se 2.500.000 lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës së tyre.

³ Të gjitha depozitat që janë në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e vendosjes së bankës në likuidim të detyruar.



ANEKSI 17

RAPORTI MUJOR I PËRPUTHSHMËRISË SË BALANCEVE TË DEPOZITAVE SIPAS
BILANCIT TË PËRGJITHSHËM ME FORMATIN E FLUKSIT TË DEPOZITAVE TË
DËRGUAR NË SISTEMIN INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM

në lek

Nr. i klasave	A Emërtimi	B Sipas bilancit ¹ në datën dd.mm.20[vv]	C Sipas raportimit në sistemin e Agjencisë ² në datën dd.mm.20[vv]	D Diferencat	Sqarime për diferencat
	Totali i depozitave të individëve				
	Totali i depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare				
	Totali i depozitave të pasigurueshme				
	<i>Në këtë total përfshihen</i>				
	Llogari rrjedhëse				
1311	Llogari rrjedhëse me bankat rezidente				
1312	Llogari rrjedhëse me institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare rezidente				
1319	Interesi i përlogaritur				
13191	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse në banka				
13192	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1321	Llogari rrjedhëse në bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare jorezidente				
1329	Interesa të përlogaritur				
	Depozita pa afat				
1611	Depozita pa afat				
16111	Depozita në banka				
16112	Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1629	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente				
	Depozita me afat				
1612	Depozita me afat				
16121	Depozita në banka				
16122	Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1619	Interesa të përlogaritur				
16191	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat në banka				
16192	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
16193	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në banka				
16194	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
1622	Depozita me institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente				
1629	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat në institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare jorezidente				
	Llogari rrjedhëse me qeverinë shqiptare dhe administratën publike				
2611	Qeveria qendrore				
2612	Qeveria rajonale				
2613	Qeveria lokale				
2617	Të tjera				
2619	Interesi i përlogaritur				
26191	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë qendrore				
26192	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë rajonale				
26193	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë lokale				



26194	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të tjera				
	<i>Depozita pa afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2631	Qeveria qendrore				
2632	Qeveria rajonale				
2633	Qeveria lokale				
2637	Të tjera				
2639	Interesi i përlogaritur				
26391	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë qendrore				
26392	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë rajonale				
26393	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë lokale				
26394	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të tjera				
	<i>Depozitat me afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2641	Qeveria qendrore				
2642	Qeveria rajonale				
2643	Qeveria lokale				
2647	Të tjera				
2649	Interesi i përlogaritur				
26491	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë qendrore				
26492	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë rajonale				
26493	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë lokale				
26494	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të tjera				
	<i>Llogari rrjedhëse me qeverinë shqiptare dhe administratën publike</i>				
2611	Qeveria qendrore				
2612	Qeveria rajonale				
2613	Qeveria lokale				
2617	Të tjera				
2619	Interesi i përlogaritur				
26191	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë qendrore				
26192	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë rajonale				
26193	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të qeverisë lokale				
26194	Interesi i përlogaritur për llogaritë rrjedhëse të tjera				
	<i>Depozita pa afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2631	Qeveria qendrore				
2632	Qeveria rajonale				
2633	Qeveria lokale				
2637	Të tjera				
2639	Interesi i përlogaritur				
26391	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë qendrore				
26392	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë rajonale				
26393	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të qeverisë lokale				
26394	Interesi i përlogaritur për depozitat pa afat të tjera				
	<i>Depozitat me afat nga qeveria shqiptare dhe administrata publike</i>				
2641	Qeveria qendrore				
2642	Qeveria rajonale				
2643	Qeveria lokale				
2647	Të tjera				
2649	Interesi i përlogaritur				
26491	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë qendrore				
26492	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë rajonale				
26493	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të qeverisë lokale				
26494	Interesi i përlogaritur për depozitat me afat të tjera				
	<i>Llogari rrjedhëse me qeverinë shqiptare dhe administratën publike</i>				
2611	Qeveria qendrore				
2612	Qeveria rajonale				



2613	Qeveria lokale				
2617	Të tjera				
	<i>Llogari rrjedhëse</i>				
2711	Individët				
2712	Njësi tregtare dhe industriale private				
2713	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2714	Punonjësit e bankës				
2717	Klientë të tjerë				
2719	Interesi i përlogaritur				
27191	Interesi i përlogaritur për individët				
27192	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
27193	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
27194	Interesi i përlogaritur për punonjësit e bankës				
27197	Interesi i përlogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Llogari depozitash pa afat</i>				
2721	Individët				
2722	Njësi tregtare dhe industriale private				
2723	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2724	Punonjësit e bankës				
2727	Klientë të tjerë				
2729	Interesi i përlogaritur				
27291	Interesi i përlogaritur për individët				
27292	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
27293	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
27294	Interesi i përlogaritur për punonjësit e bankës				
27297	Interesi i përlogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Llogari depozitash me afat</i>				
2731	Individët				
2732	Njësi tregtare dhe industriale private				
2733	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2734	Punonjësit e bankës				
2737	Klientë të tjerë				
2739	Interesi i përlogaritur				
27391	Interesi i përlogaritur për individët				
27392	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
27393	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
27394	Interesi i përlogaritur për punonjësit e bankës				
27397	Interesi i përlogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Certifikatat e depozitave</i>				
2741	Certifikatat e depozitave emërore				
27411	Individët				
27412	Njësi tregtare dhe industriale private				
27413	Njësi tregtare dhe industriale publike				
27414	Punonjësit e bankës				
27415	Klientë të tjerë				
274191	Interesi i përlogaritur për individët				
274192	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale private				
274193	Interesi i përlogaritur për njësitë tregtare dhe industriale publike				
274194	Interesi i përlogaritur për punonjësit e bankës				
274197	Interesi i përlogaritur për klientë të tjerë				
	<i>Llogari për mbulimin e çeqeve</i>				
2811	Individët				



2812	Njësi tregtare dhe industriale private				
2813	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2814	Punonjësit e bankës				
2815	Klientë të tjerë				
282	<i>Llogari garancie</i>				
2821	Individët				
2822	Njësi tregtare dhe industriale private				
2823	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2824	Punonjësit e bankës				
2825	Klientë të tjerë				
	<i>Llogari të bllokuara për garanci</i>				
2831	Individët				
2832	Njësi tregtare dhe industriale private				
2833	Njësi tregtare dhe industriale publike				
2834	Punonjësit e bankës	-			
2835	Klientë të tjerë				
2861	<i>Llogari të tjera individë</i>				
2862	<i>Llogari të tjera njësi tregtare dhe industriale private</i>				
2863	<i>Llogari të tjera njësi tregtare dhe industriale publike</i>				
2864	<i>Llogari të tjera punonjës banke</i>				
	<i>Llogari të tjera punonjës për klientë të tjerë</i>				
	<i>Klasa shtesë në varësi të klasifikimit të përdorur³</i>				

Përgatitur nga: Departamenti

Miratuar nga: Departamenti

Emri:

Emri:

Pozicioni:

Pozicioni :

Data:

Data:

Shënim 1. Korrespondon me totalin e depozitave të raportuar në bilancin e bankës.

Shënim 2. Shuma në lekë duhet të korrespondojë me totalin e balancave të llogarive në lekë në kontrollin e të dhënave për flukset depozitë.

Shënim 3. Do të evidentohen klasa shtesë tek e cila raportohen depozita të individëve/tregtarëve dhe shoqërive tregtare, dhe klientëve të tjerë.

Raportimi sipas këtij aneksi kryhet me format elektronik *Excel* në adresën elektronike sskd@asd.gov.al, brenda datës 15 të çdo muaji.**VENDIM****Nr. 4192, datë 28.9.2022**

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE
DHE NDRYSHIMEVE NË UDHËZIMIN
NR. 4188, DATË 1.9.2016, “PËR
SIGURIMIN E DEPOZITAVE NË
SHOQËRITË E KURSİM-KREDITIT”**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 3, pikat 2 dhe 4; të nenit 11, shkronja “c”, nenit 25, shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e”; të nenit 26, pika 2; nenit 27, pika 1; nenit 43, pika 1, shkronjat “ç”, “d” dhe “g”; nenit 53, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, si dhe të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 25, datë 29.8.2022,

VENDOSI:

I. Në udhëzimin nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në nenin 4, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “e” fjala “*kujdestari*” zëvendësohet me fjalën “*banka agjente*”;

b) pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “ë” me përmbajtjen e mëposhtme:

“ë) “*Paraqitja unike e depozituesve (Single Customer View)*” janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike, në sistemin informatik të shoqërisë së kursim-kreditit, nëpërmjet të dhënave të tij identifikuese, ku përvaktohen saktë depozitat e sigurueshme, si dhe shuma e kompensimit që përfiton ky depozitues.”.

2. Në nenin 17, pika 12, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me përmbajtjen e mëposhtme:



“d) miratimin për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë.”.

3. Në nenin 20, pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Agjencia zotëron Sistemin e saj Informatik për Raportim dhe Kompensim, me qëllim raportimin e informacionit për paraqitjen unike të depozituesve nga SHKK-të anëtare të skemës, verifikimin e saktësisë së informacionit të raportuar dhe përdorimin e tij në funksion të sigurimit dhe kompensimit të depozitave.”.

4. Neni 22 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë dhe raportimi i të dhënave në të nga SHKK-të funksionon në mënyrë të tillë që të sigurojë:

a) ngarkimin nga SHKK-të anëtare të skemës së skedarëve me të dhënat për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe të depozituesve të përjashtuar nga skema, sa herë që kërkohet nga Agjencia, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi;

b) kryerjen e kontroleve për vlerësimin e saktësisë së skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në rast ngjarjeje sigurimi, ose për qëllim simulimi;

c) krijimin e listëpagesës me paraqitjen unike të depozituesve, si dhe dërgimin e saj në rast simulimi ose kompensimi, në subjektet e përcaktuara në aktet nënligjore të Agjencisë;

c) vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes të shumës së siguruar dhe të përllogaritjes të primit të sigurimit të depozitave;

d) vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes të shumës së kompensimit në rast simulimi ose ngjarjeje sigurimi;

dh) prodhimin e raporteve periodike dhe atyre të kërkuara rast pas rasti nga Agjencia, për qëllim të kryerjes së analizave statistikore dhe vlerësimeve të nevojshme.”.

5. Në nenin 23, pika 1, pas fjalëve “...mbi gjendjen e depozitave” shtohen fjalët “... të nevojshme për vlerësimin e saktësisë së llogaritjes së primit të sigurimit, si dhe saktësisë së paraqitjes unike të depozituesve, në rast ngjarjeje sigurimi ose për qëllim simulimi.”.

6. Në nenin 24, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 3 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Likuidatori dhe banka agjente kanë të drejtën të njihen me informacionin që përpunohet në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, në përputhje me të drejtat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë.”;

b) pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Në rast ngjarjeje sigurimi, depozituesit kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi shumën e kompensimit, që ata përfitojnë, pranë Agjencisë, likuidatorit ose bankës agjente.”.

7. Në nenin 25, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në pikën 1, fjalët “... sipas nenit 23 të këtij udhëzimi...” zëvendësohen me fjalët “...sipas dispozitave të këtij udhëzimi”;

b) pika 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Autenticiteti i të dhënave të raportuara nga SHKK-të anëtare të skemës në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, si dhe pandryshueshmëria e tyre, verifikohet nga SHKK-të nëpërmjet kodit të gjeneruar menjëherë, pas raportimit të suksesshëm dhe të sigurt të të dhënave. Ky kod siguron se të dhënat e transmetuara kanë mbetur të pandryshuara dhe janë origjinale me dhënat e dërguara nga SHKK-të.”;

c) në pikën 7, pas fjalëve “...për periudha dhe qëllime specifike” shtohen fjalët “... të përcaktuara në këtë udhëzim.”;

d) pika 8 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“8. Për qëllim të përllogaritjes së shumës së sigurimit, SHKK-të ngarkojnë çdo muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, skedarin përkatës të depozitave të sigurueshme dhe të pasigurueshme, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.”;

e) pika 10 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“10. Në rast procesi kompensimi ose simulimi nga Agjencia, SHKK-së do t'i kërkohet të ngarkojë skedarë ditorë për paraqitjen unike të depozituesve, sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë me të dhëna mbi:

a) Depozitat – të dhënat për çdo depozitë të sigurueshme dhe të pasigurueshme në SHKK;

b) Depozituesit – të dhënat e detajuara të depozituesve të siguruar dhe të përjashtuar nga skema që i identifikojnë ata saktësisht;

c) Kreditë – kreditë e detajuara të lidhura me depozitat që janë vënë si garanci për këto kredi;

ç) Pozicioni i netuar i depozituesve – depozituesit në pozicionin e netimit.”;

f) pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“10/1 Agjencia në rast simulimi, ka të drejtën të kërkojë, nga SHKK-të anëtare të skemës, ngarkimin e



skedarit për depozituesit, të përcaktuar në pikën 10, shkronja "b" të këtij neni, me të dhëna të anonimizuara, sipas udhëzimeve të saj.”

8. Në nenin 28, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“2. SHKK-ja dërgon për miratim pranë Agjencisë kërkesën për krijimin e përdoruesit të autorizuar ose mbylljen e tij, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 6 të këtij udhëzimi, si dhe kërkesën për akses në rrjetin privat virtual (VPN), sipas formatit të kërkesës, të përcaktuar në aneksin 6/1 të këtij udhëzimi.”;

b) pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2/1 Përdoruesit e autorizuar të SHKK-ve zbatojnë udhëzimet e Agjencisë për aksesin në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim, nëpërmjet rrjetit virtual (VPN). Në rast se përdoruesi i autorizuar nuk është aktiv për më shumë se tre muaj, Agjencia ka të drejtë të kryejë çaktivizimin e tij. Riaktivizimi i përdoruesit mund të bëhet me kërkesë me email nga SHKK-ja, dërguar personit të autorizimit të Agjencisë.”

9. Në nenin 30, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 1 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“1. Agjencia ruan të dhënat për përllogaritjen e primit të sigurimit për një periudhë 5(pesë)-vjeçare nga data e raportimit të skedarëve të depozitave në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim. Agjencia ruan të dhënat për procesin e simulimit vetëm gjatë kohëzgjatjes së këtij procesi.”;

b) në pikën 2, fjalët “... në sistemin informatik informacionin dhe të dhënat e raportuara për depozitat...” zëvendësohen me fjalët “... në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim informacionin dhe të dhënat e raportuara për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe listëpagesën e depozituesve, ..”.

10. Në nenin 31, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në emërtimin e nenit, pas fjalëve “...për mbajtjen e regjistrat të tyre elektronik...” shtohen fjalët “... për paraqitjen unike të depozituesve”;

b) në pikën 1, pas fjalëve “... në përputhje me anekset 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.” shtohen fjalët “... për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet, nga data e raportimit të këtyre të dhënave në Agjenci.”;

c) pika 2 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. SHKK-të mundësojnë gatishmërinë e prodhimit të skedarëve për krijimin e paraqitjes unike të depozituesve, në

çdo kohë dhe sipas kërkesës së Agjencisë, në përputhje me aneksin 4 të këtij udhëzimi.”;

d) pika 3 shfuqizohet;

e) në pikën 5, fjalët “.., si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme lidhur me përfshirjen e tyre në sistemin informatik dhe zbatimin e akteve nënligjore përkatëse.”, zëvendësohen me fjalët “.., si dhe lidhur me mbajtjen, përgatitjen dhe raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve, si dhe auditojnë përputhshmërinë e zbatimit të kërkesave të Agjencisë, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.”.

11. Në nenin 33, pika 2 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Raportin për depozituesin me informacionin përkatës, që nxirret nga Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë, në rast ngjarjeje sigurimi, bazuar në kërkesën e tij.”.

12. Neni 36 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Agjencia kryen verifikime për kontrollin e përmbushjes së kushteve për sigurimin dhe kompensimin e depozitave nga SHKK-të, të cilat paraqesin kërkesë për t'u anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave, SHKK-të anëtare të skemës, si dhe SHKK-të që janë në proces të riorganizimit juridik.

2. Për qëllim të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, llojet e verifikimeve që kryhen nga Agjencia janë:

a) verifikime të plota, në të cilat përfshihen çështjet e përcaktuara në nenin 37, pika 1, të këtij udhëzimi;

b) verifikime të pjesshme, në të cilat përfshihen çështjet e përcaktuara në nenin 37, pika 2 të këtij udhëzimi.

3. Agjencia ka të drejtë të kryejë:

a) verifikimet në vend, në ambientet e SHKK-së;

b) verifikime në distancë, nëpërmjet raportimeve të të dhënave dhe informacionit nga SHKK-të në Agjenci;

c) verifikime të kombinuara, duke kryer një pjesë të punës nga ambientet e Agjencisë dhe një pjesë të punës në ambientet e SHKK-së.

4. Frekuenca e kryerjes së verifikimeve të Agjencisë është si vijon:

a) verifikime të plota në vend, të paktën një herë në vit, gjatë tre viteve të para të anëtarësimit të SHKK-ve në skemën e sigurimit të depozitave;

b) verifikime të plota në vend, të paktën një herë në dy vjet, për SHKK-të të cilat janë më shumë se tre vjet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;

c) verifikime të pjesshme në distancë ose të kombinuara, çdo tre muaj, me objekt kontrollin e saktësisë së përllogaritjes të primit të sigurimit, të raportuar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;



c) verifikime të pjesshme në distancë ose të kombinuara, të paktën një herë në vit, me objekt kontrollin e gatishmërisë së sistemit të SHKK-ve anëtare, për raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim.

5. Agjencia sipas rastit kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të saj në ekzaminimet që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në SHKK.

6. Agjencia verifikon SHKK-të nëpërmjet Grupit të Verifikimit, i cili përbëhet nga punonjës të Agjencisë, sipas çështjeve konkrete të verifikimit.

7. Gjatë procesit të verifikimit SHKK-të kanë këto të drejta:

a) e drejta për t'u informuar me programin e verifikimit, i cili përmban objektin, qëllimin dhe kohëzgjatjen e procesit të verifikimit. Agjencia njofton SHKK-të të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së planifikuar për kryerjen e verifikimit, me anë të dërgimit të programit të verifikimit. Si përjashtim nga ky rregull, në raste të veçanta, kur është e nevojshme kryerja e verifikimit të menjëhershëm, afati i njoftimit mund të jetë më i shkurtër, por në çdo rast i shoqëruar me një shkrues nga Drejtori i Përgjithshëm;

b) e drejta për të komunikuar me grupin e verifikimit, me qëllim informimin mbi ecurinë e procesit të verifikimit;

c) e drejta për të shprehur komentet në lidhje me gjetjet dhe përfundimet paraprake të procesit të verifikimit. Përfundimet paraprake, që do të jenë pjesë e raportit të verifikimit, i dërgohen me email SHKK-së për komente përfundimtare, të cilat duhet të paraqiten nga SHKK-ja brenda 5 (pesë) ditësh pune. Nëse SHKK-ja nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, raporti i verifikimit do të konsiderohet i dakordësuar;

d) e drejta për të marrë nga Agjencia një kopje të raportit përfundimtar të verifikimit.

8. Gjatë procesit të verifikimit, SHKK-të kanë këto detyrime:

a) të krijojë kushtet e nevojshme logjistike për mbarëvajtjen e punës së Grupit të Verifikimit, siç janë, por pa u kufizuar: mjedise pune të dedikuara për anëtarët e grupit të verifikimit, akses në internet dhe telefon etj.;

b) të vendosë në dispozicion të Grupit të Verifikimit informacionin, të dhënat dhe dokumentet, që kanë lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave, brenda afateve dhe në formën e kërkuar prej tij;

c) të sigurojnë disponueshmërinë e personave të kontaktit dhe përgjegjës të SHKK-së për të bashkëpunuar dhe marrë pjesë në intervistat me Grupin e Verifikimit;

d) të sigurojë vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit, të të dhënave dhe dokumenteve, që i paraqitet Grupit të Verifikimit të Agjencisë;

d) t'i mundësojnë Grupit të Verifikimit, nëpërmjet personave përgjegjës të SHKK-së, akses në sistemet informatike, që përpunojnë të dhëna për depozitat dhe depozituesit, me qëllim verifikimin e tyre;

dh) të zbatojnë rekomandimet, veprimet dhe/ose masat rregulluese të përcaktuara në Raportin e Verifikimit, si dhe të raportojnë në Agjenci lidhur me ecurinë e zbatimit të tyre, në mënyrën dhe afatin e kërkuar.”.

13. Në nenin 37, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në pikën 1, fjalja “Drejtimit kryesore të procesit të verifikimit janë, por pa u kufizuar:” zëvendësohet me fjalinë “Verifikimet e plota që Agjencia kryen në SHKK kanë si objekt verifikimin e çështjeve të mëposhtme, por pa u kufizuar:”;

b) në pikën 1, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “b/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“b/1) verifikimi i SHKK-së për:

i. saktësinë e përgatitjes dhe ngarkimit në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve;

ii. gatishmërinë e sistemit elektronik të SHKK-së për të gjeneruar raportin e cilësisë së të dhënave, sipas formatit të përcaktuar nga Agjencia;”;

c) pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Verifikimet e pjesshme që Agjencia kryen në SHKK kanë si objekt verifikimin e çështjeve të mëposhtme:

a) saktësinë e përllogaritjes së primit të sigurimit të raportuar në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

b) gatishmërinë e SHKK-ve për raportimin e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim;

c) çështje të tjera me tematikë të caktuar, në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave.”.

14. Aneksi 3 i udhëzimit riemërtohet “Regjistri elektronik i detyrimeve depozitë të SHKK-së për paraqitjen unike të depozituesve”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

15. Aneksi 4 i udhëzimit riemërtohet “Parametrat teknikë që duhet të plotësojë, dhe raportet që duhet të gjenerojë sistemi informatik i SHKK-së për paraqitjen unike të depozituesve”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

16. Aneksi 6 i udhëzimit “Kërkesë për akses në sistemin informatik për raportim dhe kompensim” zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i



bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Pas Aneksit 6, shtohet aneksi 6/1 “*Kërkesë për akses në rrjetin privat virtual (VPN)*”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Në Aneksin 8, formulari 2 i udhëzimit “*Aneks i kontratës së depozitës për informimin e publikut*”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

19. Aneksi 18 “*Raporti mujor i përputhshmërisë së balancave të depozitave sipas bilancit të përgjithshëm me formatin e fluksit të depozitave të dërguar në Sistemin Informativ për Raportim dhe Kompensim*” zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

20. Termat “*sistem*”, “*sistemi i Agjencisë*”, “*sistemi informatik*”, “*sistemi informativ*” dhe “*sistemi elektronik*” zëvendësohen me termin “*Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim*”, përkatësisht në nenin 4, pika 1, shkronja “e”; në nenin 15, pika 6; në nenin 21; në nenin 24, pika 1, pika 2; në nenin 25, pika 1, pika 2, pika 6; në nenin 26, pika 4, pika 5, pika 6; në nenin 27; në nenin 28, pika 3; në nenin 29 – emërtimi, pika 1, pika 3; neni 30 – emërtimi, pika 3; në nenin 31, pika 4, pika 6; në nenin 32; në nenin 33; në nenin 34, pika 1 dhe në nenin 35 të udhëzimit.

II. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

III. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

GUVERNATORI
Gent Sejko

ANEKSI 3

REGJISTRI ELEKTRONIK I DETYRIMEVE DEPOZITË TË SHKK-së PËR PARAQITJEN UNIKE TË DEPOZITUESVE

SHKK-të mbajnë informacione dhe të dhëna të sakta e të detajuara për paraqitjen unike të depozituesve si vijon:

1. Mban dhe siguron me një kod të vetëm (unik) çdo depozitues me këto të dhëna të detyrueshme (në sistemin elektronik të SHKK-së dhe në letër):

a) të dhënat për individët: emër, mbiemër, atësi, **numër personal, të dhënat për mjetin e identifikimit**, gjini, datëlindjen, adresën, numrin e telefonit;

b) të dhënat për tregtarët dhe shoqëritë tregtare: **numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)**, data e regjistrimit, emërtimi i subjektit, forma ligjore;

c) të dhënat për depozitat: kodi unik i depozitës, tipin e depozitës, numrin e titullarëve të depozitës dhe lidhjen e tyre me depozitat përkatëse; balancën e depozitës, monedhën e depozitës, normën e interesit, interesin e llogaritur në ditën e vlerësimit/ndërhyrjes, kursin e këmbimit.

2. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave kolateral ose të vendosura si garanci dhe të dhënat analitike të kredive të SHKK-së për të cilat këto depozita janë barrësuar.

3. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin në sistemet elektronike të informacionit të të dhënave analitike për kreditë që ka çdo depozitues në SHKK.

4. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit të depozitave të vendosura në përfitim të të tretëve me/pa kusht dhe afat përfitimi me të dhënat analitike të kontratave përkatëse.

5. Mban dhe siguron në çdo rast evidentimin me një shenjë të veçantë në sistemet elektronike të informacionit për depozitat dhe depozituesit e SHKK-së që janë të përjashtuar nga skema e sigurimit të depozitave.

6. Mban dhe siguron identifikimin dhe gjurmimin, nëse dërgesat dhe instrumentet e pagesave (p.sh. urdhër në arkë, transferta



ndërbankare, transfertat nëpërmjet internetit, e të tjera transfertat elektronike) janë të bëra nëpërmjet pagesave “cash” ose duke debituar llogarinë e depozitës. Kjo gatishmëri është në funksion të administrimit e rregullimeve që lidhen me balancat e depozitave, me dërgesat pezull dhe faturat gjendje - të pagueshme.

7. Mban dhe siguron gjurmimin nëse çeqet e kredituara nga llogaritë e depozitave janë ekzekutuar (ose imazhi i çeqeve të dëmtuar, është dërguar) për klering. Ky informacion përcakton nëse shumat e depozitave të siguruar duhet të korrigjohen për efekt të çeqeve të paekzekutuara për klering dhe çeqet e kthyera mbrapsht.

ANEKSI 4

PARAMETRAT TEKNIKË QË DUHET TË PLOTËSOJË DHE RAPORTET QË DUHET TË GJENEROJË SISTEMI INFORMATIK I SHKK-së PËR PARAQITJEN UNIKE TË DEPOZITUESVE

1. Sistemi informatik i SHKK-së duhet të mundësojë në çdo kohë, vendosjen e parametrave të mëposhtëm:

- a) shuma e mbulimit;
- b) kursi zyrtar i këmbimit në ditën e vlerësimit;
- c) kodin unik të identifikimit të depozituesit;
- ç) të gjitha kategoritë e produktit depozitë për depozituesin subjekt i skemës;
- d) të gjitha kategoritë e produktit kredi për depozituesin subjekt të skemës;
- dh) detyrime të tjera të depozituesit ndaj të tretëve.
- e) kushtet përjashtuese sipas nenit 32, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

2. Sistemi informatik i SHKK-së duhet të mundësojë në çdo kohë gjenerimin e raporteve të mëposhtme:

- a) paraqitjen unike të çdo depozituesi (individ, tregtar, shoqëri tregtare) të SHKK-së lidhur me:

- i. të dhënat identifikuese të tij;
- ii. depozitat e tij (secilën nga depozitat dhe të marra së bashku);
- iii. detyrimet në vonesë ndaj SHKK-së (kredi, overdraft, garanci, etj., çdo detyrim më vete, si dhe të marra së bashku);
- iv. pozicionin neto të tij (depozita - kredi, të drejta - detyrime në vonesë);
- b) listën e plotë të depozituesve të SHKK-së që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, së bashku me shumën përkatëse të depozitave të agreguara;
- c) listën e depozituesve të SHKK-së që nuk janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave sipas nenit 32, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;
- ç) listën e depozitave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të depozitave sipas nenit 32, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;
- d) konvertimin në lekë të të gjitha depozitave në monedhë të huaj me kursin zyrtar të këmbimit, të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit/ndërhyrjes, sipas kërkesës së Agjencisë;
- dh) listën e depozituesve që kanë një detyrim kundrejt SHKK-së, me shumën përkatëse të kredisë që ata kanë;
- e) listën e depozituesve që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm, të shoqëruar me shumën përkatëse të depozitave të tyre krahasuar me nivelin e mbulimit;
- ë) listën e depozituesve me shumën e kësteve të papaguara në afat që burojnë nga marrëdhënia kreditore e depozituesit me subjektin;
- f) evidentimi i depozitave kolateral dhe i depozitave të vendosura në përfitim të të tretëve;
- g) listën e të gjithë klientëve aktivë, si dhe klientëve dormant me vlerë më të madhe se zero;
- gj) raporte të ndryshme statistikore në varësi të situatave të ndryshme që do të paraqiten.



ANEKSI 6

KËRKESË PËR AKSES NË SISTEMIN INFORMATIK PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES

Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar një përdorues të ri (të autorizuar) ose për të mbyllur një përdorues ekzistues (të autorizuar).

Për: **Agjencia e Sigurimit të Depozitave**
Sektori i Teknologjisë së Informacionit

Nga SHKK-ja: _____

Data e kërkesës: __/__/____
(dd/mm/vvvv)

Nr.	Emër Mbiemër i përdoruesit	Adresa e <i>email</i> -it	Veprimi
			☐ Krijim përdoruesi
			☐ Mbyllje përdoruesi
			☐ Krijim përdoruesi
			☐ Mbyllje përdoruesi

Për SHKK-në

Autorizuesi i kërkesës

(_____)

Për Agjencinë

Autorizuesi i kërkesës

(_____)



ANEKSI 6/1
KËRKESË PËR AKSES NË RRJETIN PRIVAT VIRTUAL (VPN)

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES

Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar përdorues të ri ose për të mbyllur përdorues ekzistues.

Për: **Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Sektori i Teknologjisë së Informacionit**

Nga SHKK-ja: _____

Data e kërkesës: __/__/____
(dd/mm/vvvv)

Nr.	Përdoruesi	Adresa e email-it	Veprimi
			☐ Krijim përdoruesi
			☐ Mbyllje përdoruesi

Për SHKK-në

Autorizuesi i kërkesës
(_____)

Për Agjencinë

Autorizuesi i kërkesës
(_____)

FORMULARI 2
ANEKS I KONTRATËS SË DEPOZITËS
PËR INFORMIMIN E PUBLIKUT
FORMULARI I INFORMIMIT TË DEPOZITUESIT

Informacion bazë për sigurimin e depozitave në (emri i institucionit, SHKK-së)

Depozitat në SHKK..... (emri i SHKK-së) janë të siguruara nga:	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Niveli maksimal i mbulimit:	LEKË 2.000 000 për çdo depozitues në çdo SHKK ⁴
